REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr.2556/1 Prot. Lushnje 19 / 03 / 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 31, datë 19.03. 2025

Për miratimin e dokumentit "Draft Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit", në territorin e Bashkisë Lushnje(2025-2031).

Në mbështetje të nenit 3, "Misioni i vetëqeverisjes vendore ", të nenit 9, "Të drejtat dhe përgjegjësitë", nenit 29 "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", nenit 18 "Seancat e këshillimeve me bashkësinë" dhe nenit 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; nenit 10 "Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë" nenit 11 "Draft Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë", nenit 12 "Harmonizimi i planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të nenit 30 "Bashkitë", shkronja "c", të nenit 67, "Inspektimi" shkronja "b" si edhe të nenit 68 "Kundërvajtjet administrative", të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", për hartimin dhe miratimin e dokumentit "Draft Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit", në territorin e saj, Bashkia Lushnje,

PROPOZON:

1. Miratimin e dokumentit "Draft Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit " në territorin e Bashkisë Lushnje, sipas kërkesave të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

2. Ky dokument të konsiderohet si një dokument themelor për planifikimin dhe zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe për zhvillimin urban në territorin e Bashkisë Lushnje. Dokumenti të publikohet dhe të bëhet i aksesueshëm për të gjitha

Drejtoritë përkatëse dhe për publikun, si dhe të përdoret si referencë në hartimin e planeve dhe strategjive të tjera zhvillimore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Sektori i Mbrojtjes Civile.

Sektori i Mbrojtjes Civile
Përgjegjës: Avni Begolli

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Ervisa Çuko

KRYETARE
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Ky raport u përgatit nga Bashkia Lushnje, me mbështetjen teknike të MetroPOLIS dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në kuadër të projektit projektit RESEAL, financuar nga UNDP – Albania, dhe me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Grupi i Punës Bashkia Lushnje – Per tu Plotesuar me emrat e grupit te punes

Grupi i Punës UNDP - Per tu Plotesuar me emrat e grupit te punes

Grupi i Punës AKMC - Per tu Plotesuar me emrat e grupit te punes

Grupi i Punës MetroPOLIS Sh.p.k & Co-PLAN - Per tu Plotesuar me emrat e grupit te punes

Projekti 'Hartimi i Planeve Strategjike për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkitë e Qarkut Fier' financohet nga UNDP në kuadër të projektit: "Forcimi i aftësive ripërtëritëse në Shqipëri" RESEAL dhe mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Projekti RESEAL financohet nga Qeveria Suedeze dhe ajo Portugeze. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit".

Përmbajtja

1. Hyrja 6

1.1 Kuadri institucional dhe ligjor 10

1.2 Procesi i përgatitjes së stragjisë së ZRF 10

1.3 Dokumentet Strategjike Kombëtare dhe Lokale 12

2. Konteksti i ZRF-ve bashkiake 13

2.1 Vlerësimi i riskut 13

2.2 Kapacitetet financiare të Bashkisë 21

2.3 Donatorë, projekte, programe dhe mundësi të tjera financimi 24

3. Vizioni, Synimi dhe Objektivat Strategjike 26

4. Projektet dhe Masat Strategjike 27

4.1 Masat Institucionale dhe Zhvillimi i Kapaciteteve 27

4.2 Plani i Veprimit dhe Boshllëku Financiar 37

4.3 Zbatimi i Strategjisë 46

4.4 Monitorimi 46

5. Referencat 47

6. Anekset 47

Aneks 1 – Projekte të ekstraktuara nga plane dhe strategji kombëtare dhe sektoriale 47

Aneks 2 - Minutat e takimit hapës për projektitn "Hartimi i Strategjive Vendore për Zvoglimin e Riskut nga Fatkeqsitë dhe Planet e Veprimit për 6 Bashkitë e Qarkut Fier" 51

Aneks 3- Takim me grupin e punës në Bashkinë Lushnje 58

Aneks 4. Takimi me grupin e punes në Bashkinë Lushnje 59

Aneks 5- Kuadri Ligjor 62

Aneks 6- Kuadri Strategjik 65

Akronime

AAL-BL - Average Annual Loss - Bashkia Lushnje (Humbjet mesatare vjetore)
AAL-QF - Average Annual Loss - Qarku Fier (Humbjet mesatare vjetore)
AKBN - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKMC - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AMBU - Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASIG - Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BB - Banka Botërore
BE - Bashkimi Evropian
BKU - Banesa me Kosto të Ulët
BSQ - Programi i Banesave Sociale me Qira
FAU - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
FGJM - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
FIN - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
FTI - Fakulteti i Teknologjise se Informacionit
GES - Gaze të efektit serrë
IADSA - Programi i Shkëmbimit të Borxhit Italo-Shqiptar për Zhvillim (Italian-Albanian Debt for Development Sëap Programme)
IAP - Ionian Adriatic Pipeline (Gazsjellësi Jon Adriatik)
IGJEO - Instituti i Gjeoshkencave
ISHTI - Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
JICA - Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Japan International Cooperation Agency)
KKSh - Kryqi i Kuq Shqiptar
KMC - Komiteti i Mbrojtjes Civile
MAS - Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB - Ministria e Brendshme
MBZhR - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MC - Mbrojtje Civile
MIE - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
ML - Ministritë e linjës
MM - Ministria e Mbrojtjes
MMC BE - Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
MRF - Menaxhimi i Riskut nga Fatkeqësitë
MRF - Menaxhimi i risqeve nga fatkeqësitë
MShMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NbS - Nature-based Solutions/Zgjidhje me bazë natyrën
NDC - National Determined Contribution (Kontributi i Dakordësuar Kombëtar)
NjA - Njësi Administrative
OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ - Organizata Jo Qeveritare
OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
OS - Objektiv Strategjik
OSHC - Organizata të Shoqërisë Civile
PBB - Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKEC - Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PKEC - Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PPK - Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Zhvillimit të Territorit
PPKB - Programi i Përmirësimit të Kushteve të Banimit
PPV - Plani i Përgjithshëm Vendor
QKKSH - Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit
SKZRF - Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SKZRF - Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SVZRF - Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SVZRF - Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SHGJSH - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ShMZSh - Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
TAP - Trans Adriatic Pipeline (Gazsjellësi Trans Adriatik)
UPT - Universiteti Politeknik i Tiranës
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave
VRF - Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë
VRF - Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë
VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZRF - Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë
ZRF - Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë

1. Hyrja

Për shkak të tërmeteve, cunamit, përmbytjeve bregdetare dhe të lumenjve, cikloneve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit për të 193 vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara, bazuar në ekspozimin dhe cenueshmërinë (ndjeshmërinë dhe kapacitetet përshtatëse), Shqipëria ka një indeks risku "të lartë"- dhe renditet e 6-ta në Evropë dhe e 76-ta në botë.
Skenarët e ardhshëm klimatikë për Shqipërinë parashikojnë ndryshime, si prirjet në rritje të temperaturave vjetore dhe sezonale, si në vlera minimale ashtu edhe maksimale, ulje të reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Sipas Komunikatës së Tretë Kombëtare (NCC) të Marrëveshjes së Konventës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet Klimatike (UNFCCC), deri në verën e vitit 2050, zona bregdetare nuk ka gjasa të përjetoje temperatura mesatare nën 25°C; Deri në vitin 2100, temperatura mesatare deri në 30°C pritet të dominojnë të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, të gjithë skenarët parashikojnë një ulje të mundshme të reshjeve sezonale në të gjitha stinët krahasuar me vlerat e vitit 1990.

Në këtë drejtim për të mbështetur Qeverinë Shqiptare, PNUD në Shqipëri po zbaton projektin Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri, RESEAL, i cili synon të forcojë sistemin ZRF të Shqipërisë dhe të mbështesë përpjekjet e vendit për t'u bërë një anëtar i plotë i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Përveç kësaj, ky projekt do të mbështesë zhvillimin e kornizës ZRF në nivel bashkiak, në përputhje me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (SFDRR).

Kuadri Sendai Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030 u miratua në Konferencën e tretë Botërore të KB në Sendai, Japoni, më 18 Mars 2015. Kuadri Sendai artikulon nevojën për të kuptuar më mirë riskun ndaj fatkeqësitë në të gjitha dimensionet si ekspozimi, ndjeshmëria dhe karakteristikat e rrezikut. Gjithashtu advokon për forcimin e qeverisjes duke përfshirë platformat kombëtare si dhe rritjen e përgjegjësisë për menaxhimin e gatishmërinë për të "Ndërtuar më mirë" pas një fatkeqësie.

Kuadri Sendai propozon 4 prioritete përsa i përket ZRF:

Prioriteti 1: Kuptimi i riskut të fatkeqësisë.
Prioriteti 2: Forcimi i qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të menaxhuar riskun.
Prioriteti 3: Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për të rritur aftësinë ripërtëritëse.
Prioriteti 4: Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për përgjigje efektive dhe për të "Rindërtuar më mirë" në rimëkëmbje, rehabilitim dhe rindërtim.

Me qëllim marrjen e masave parandaluese për ti bërë ballë ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, Qeveria Shqiptare në vitin 2023 miratoi Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për periudhën 2023-2030, një dokument thelbësor për sektorin e Mbrojtjes Civile.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është një dokument i rëndësishëm që ka për qëllim të adresojë sfidat e paraqitura nga fatkeqësitë dhe të ndërmarë veprime për t'i zvogëluar ato, si dhe të orjentojë aktivitetet dhe investimet e ardhshme për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në mënyrë gjithëpërfshirëse e ndër-sektoriale. Ky dokument është përgatitur nga

autoritetet shqiptare dhe është një ndër detyrimet ligjore të Ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile". Në kuadër të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive, ky dokument promovon vendosjen e objektivave dhe masave për të bërë Shqipërinë një vend me aftësi ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. Për më tepër, në samitin e fundit të Platformës Globale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Indonezi, shtetet anëtare ranë dakord për Axhendën e Balit për aftësinë ripërtëritëse

Në rast të risqeve nga fatkeqësitë, institucioni parësor ku qytetarët drejtohen është Bashkia. Kryesisht koncepti i Zvogëimit të Riskut të Fatkeqësive është relativisht i ri, si për qytetarët, ashtu edhe për pushtetin vendor. Pjesa më e madhe e bashkive nuk janë të përgatitura sa duhet për ZRF, si nga ana e kapaciteteve njerëzore apo teknike, ashtu edhe nga ajo financiare. Nga ana tjetër, ka pasur një mungesë të përgjithshme të të kuptuarit të politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel lokal, duke rezultuar në zhvillim të painformuar nga perspektiva e rrezikut nga fatkeqësitë.

Qarku i Fierit, konkretisht Bashkia Lushnje për shkak edhe të pozicionit të saj gjeografik, si dhe pasurisë ujore dhe relievit të saj, konsiderohet si një Bashki e ekspozuar ndaj riskut të fatkeqësive natyrore.

Referuar Raportin e Vlerësimit të Riskut në Shkallë Vendore, të hartuar nga Bashkia Lushje me mbështetjen e projektit RESEAL, vlerësohet se gjashtë risqet e marra në konsideratë vlerësohen me shkallë të lartë ndikimi. Këto vlerësime japin një kuptim paraprak mbi nevojat më urgjente në bashki dhe sektorët ku duhet patur një fokus të veçantë. Gjithashtu, nevojitet bashkpunimi në nivel qarku, duke marrë parasysh që një pjesë e problematikave prekin më shumë se një bashki.

Për këtë arsye është e nevojshme që bashkitë të marrin hapa konkret për parandalimin e riskut duke qenë në përputhje me ligjin, nr. 45/2019, datë 18.07.2019, "Për mbrojtjen civile" dhe Strategjinë VRF duke vijuar me hartimin e Strategjive vendore për ZRF të cilat janë hapi i parë i adresimit të problematikës në mënyrë institutcionale.

Strategjia vendore për ZRF është mjeti gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik bashkiak që përcakton qëllimet dhe objektivat e përgjithshme në periudha të ndryshme kohore, duke marrë në konsideratë periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, e duke përqafuar njëkohësisht një perspektivë afatgjatë. Ky dokument synon të parandalojë risqet e reja dhe të zvogëlojë ato ekzistuese, të ofrojë alternativa për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë dhe të forcojë aftësinë ripërtëritëse ekonomike, sociale, shëndetësore dhe mjedisore të banorëve. Startegjia ndërtohet mbi kontekstin lokal dhe profilin e riskut, duke përcaktuar qëllimet e përgjithshme, objektivat, parimet, udhëzimet, prioritetet për veprim, kostot dhe afatin kohor përkatës.
Ky dokument do ti lejojë bashkisë të hartojë edhe Planet Vendore të ZRF si dhe koordinojë nevojën për investime e rritje kapacitetesh në këtë sektor për të siguruar jetën e qytetarëve dhe zhvillimin e qendrueshëm të bashkisë.

Përmbatja e strategjisë

Strategjia e Zvogëlimit të Riskut në nivel vendor përbëhet gjithsej nga 14 kapituj, ku përfshihen dhe referencat (dokumente ku është bazur strategjia) apo anekse (dokumente plotësuese të strategjisë. Shkurtismisht, përmbatja e strategjisë është si më poshtë:

- Hyrje – Nëpërmjet këtij kapitulli përcaktohet konteksti për përgatitjen e strategjisë. Ofron një prezantim të përgjithshëm të bashkisë, faktorëve kryesorë të riskut që prekin bashkinë si dhe në përgjithësi në Shqipëri. Hyrja përshkruan se si është përgatitur strategjia dhe roli i saj në qeverisjen e përgjithshme të bashkisë.

- Kuadri institucional - Ky seksion i hyrjes fokusohet kryesisht në kuadrin institucional dhe ligjor. Ai përshkruan në detaje kuadrin institucional për qeverisjen e ZRF-së në nivel lokal. Për më tepër, ai ofron një përshkrim të përgjithshëm të kuadrit ligjor i cili merret me ZRF-në si dhe legjislacione të tjera sektoriale që preken ose mund të ndikojnë në zbatimin e strategjisë dhe Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në përgjithësi.
- Procesi i përgatitjes së strategjisë - Këtu është paraqitur një përshkrim i detajuar i metodologjisë dhe procesit për përgatitjen e strategjisë. Një fokus i veçantë do i kushtohet edhe konsultimit të strategjisë në nivele të ndryshme si komunitare, institucionale, fokus grupe me ekspertë dhe në nivel qarku ndërmjet të gjitha bashkive. Ky seksion do të lidhet me një aneks të dedikuar me minutat e takimeve, foto dhe çdo dëshmi tjetër që është e mundur.
- Dokumentat strategjike lokale dhe kombëtare - Ky seksion ofron një analizë të detajuar të dokumenteve dhe instrumenteve të miratuara ose në proces hartimi në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Në nivel kombëtar dokumentet kryesore që do të shqyrtohen janë: Strategjia Kombëtare për ZRF, Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror, Plani Kombëtar për Emergjencat Civile, Plani Kombëtar i Zhvillimit të Territorit, Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike si dhe çdo plan tjetër sektorial që mund të ndikojë në ZRF. Në nivel vendor, dokumentet kryesore që do të merren në konsideratë janë Plani i Përgjithshëm Vendor i Territorit, çdo strategji apo plan tjetër sektorial në nivel vendor.
- Vlerësimi i riskut - Ky seksion ofron një përmbledhje të vlerësimit të riskut duke u fokusuar në 6 risqet kryesore që janë identifikuar gjatë fazës së vlerësimit të riskut. Nëpërmjet përmbjedhjes së risqeve theksohen edhe pikat kryesore që duhet të adresohen për secilin prej tyre. Kjo përbën bazën për përgatitjen e projekteve dhe masave në hapat e ardhshëm.
- Kapacitetet financiare të bashkisë - Ky seksion analizon kapacitetet financiare që ka bashkia në lidhje me ZRF. Përveç analizës financiare të Sektorit të Mbrojtjes Civile, realizohet edhe një kuptim i kapaciteteve financiare të sektorëve të tjerë që ndikojnë në ZRF. Është e rëndësishme pasi shumë aktivitete që kryhen nga sektorë të tjerë si infrastruktura, shëndetësia, bujqësia, mjedisi, planifikimi i territorit, kontribuojnë drejtpërdrejt në ZRF. Së fundi, plani buxhetor afatmesëm dhe planet buxhetore vjetore analizohen për të kuptuar projeksionet e bashkisë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.
- Donatorë, projekte, programe dhe mundësi të tjera financimi - Duke marrë parasysh kapacitetet e limituara financiare bashkiake në përgjithësi, dhe veçanërisht për sektorin e mbrojtjes civile, është e rëndësishme edhe një analizë e detajuar e mundësive të tjera të financimit. Kjo përfshinë mundësi financimi nëpërmjet granteve konkurruese nga institucionet shqiptare si Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), mundësi financimi nga grante konkurruese nëpërmjet financimit të BE-së si Bashkëpunimi Ndërkufitar IPA, Bashkëpunimi Transnacional IPA, Grantet IPA, Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së, Horizon EUROPE, ose çdo mundësi tjetër financimi e

lidhur me BE-në, dhe së fundi një analizë e programeve të donatorëve që operojnë në zonë dhe mund të mbështesin ZRF.

- Vizioni, synimi dhe objektivat strategjike - Në këtë kapitull zhvillohet vizioni, qëllimi i strategjisë dhe objektivat strategjike. Për çdo objektiv strategjik, bëhet një përshkrim i detajuar, duke përfshirë identifikimin e projekteve dhe masave për secilin nga objektivat e deklaruara. Kjo do të lejojë që objektivat të jenë të matshëm.
- Projektet dhe masat strategjike - Ky seksion fokusohet në masat institucionale që duhet të ndërmerren nga çdo bashki për të rritur kapacitetet në fusha të ndryshme të ZRF. Kjo mund të përfshijë ristrukturimin e sektorit të mbrojtjes civile, trajnime, etj. Gjithashtu është paraqitur një listë e projekteve strategjike. Çdo projekt strategjik do të shkruhet në formën e një skedari projekti, duke përfshirë një përshkrim të shkurtër, buxhetin për zbatimin, kornizën kohore dhe Tregues Monitorimië matës.
- Plani i veprimit dhe boshlleku financiar - Ky seksion përbëhet nga tabela e planit të veprimit. Tabela do të nxjerrë në pah fushat kryesore të secilit projekt, institucionet zbatuese dhe financuese, koston e projektit, si dhe hendekun financiar. Aty ku është e mundur, në rast se një projekt mund të ketë aktivitete ose masa të ndryshme, do të përllogaritet një kosto për secilin aktivitet për të mundësuar gjithashtu financimin e pjesshëm dhe ndarjen me faza të projekteve.
- Zbatimi i strategjisë - Ky kapitull fokusohet në përcaktimin e masave të ndryshme që kbashkia duhet të marrë për zbatimin e projektit. Këtu diskutohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërsektorial, si dhe koordinimi me bashkitë e tjera kufitare dhe me institucionin e Prefekturës. Këtu diskutohen edhe çështje të harmonizimit, për shembull me Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit.
- Monitorimi - Këtu parashtrohen të gjithë treguesit për matjen e zbatimit të strategjisë kundrejt përmbushjes së objektivave strategjik të përcaktuar në këtë dokument. Përveç kësaj, zhvillohet një grup i përgjithshëm treguesish që kanë si fokus monitorimin e përgjithshëm të ZRF në bashki dhe kontributin e saj në Kuadrin SENDAI.

1.1 Kuadri institucional dhe ligjor

Vitet e fundit Shqipëria ka përditësuar dhe miratuar kornizën ligjore dhe institucionale që adreson çështjet e mbrojtjes civile, duke i dhënë një theks të veçantë vlerësimit dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë. Përgatitja dhe miratimi i kësaj kornize ligjore dhe institucionale është kryer në kuadër të proceseve të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Për ngritjen e kësaj pakete është ndjekur një qasje gjithpërfshirëse me qëllim ngritjen dhe përforcimin e kapaciteteve të strukturave institucionale përkatëse.
Ligji bazë është Ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019, "Për mbrojtjen civile", i cili ka vënë në zbatim pjesërisht edhe disa Direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian që kanë të bëjnë me mbrojtjen civile dhe vlerësimin e zvogëlimin e riskut të fatkeqësive sikurse janë:

- **Direktiva (BE) 2021/836** e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 20 maj 2021 që ndryshon Vendimin Nr. 1313/2013/BE "Për Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit"
- **Vendim (BE) 2019/**420 i Parlamentit dhe e Këshillit Evropian i datës 13 mars 2019 që ndryshon Vendimin Nr. 1313/2013/BE "Për Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit"
- **Direktiva 2007/60/KE** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007, "Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmbytjeve", numri CELEX 32007L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 288/27, datë 6.11.2007, faqe 27-34.
- **Vendimi nr. 1313/2013/BE**, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013, "Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian", i ndryshuar. Numri CELEX 3213D1313, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, tat- 20.12.2013, faqe 924-947.
- **Vendimi zbatues i Komisionit 2014/762/BE**, datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr. 1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian" dhe që shfuqizon vendimet e Komisionit 2004.277/KE, Euroatom dhe 2007/'606/KE, Euroatom:, i ndryshuar. Numri CELEX 32014Do762, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 320, datë 6.11.2014, faqe 1-45.

Kjo kornizë ligjore përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve (qendrore dhe vendore), subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në tërësi, përsa i përket çështjeve të vlerësimin dhe zvogëlimi të riskut të fatkeqësive.
Gjithashtu, për përgatitjen e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë janë marrë në konsideratë edhe ligje apo akte nënligjore të cilat adresojnë në mënyrë direkte apo indirekte çështje që lidhen me mbrojtjen civile.

Në këtë kornizë ligjore përcaktohen institucionet dhe strukturat vendore përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes civile, të cilat janë prefekti i qarkut, komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkitë. Brenda ligjit gjithashtu nënvizohen edhe detyrimet përkatëse të këtyre strukturave institucionale. Ligji thekson që bashkitë kanë detyrimin për hartimin dhe miratimin e dokumentit të vlerësimit të riskut të fatkeqësive, strategjisë të zvogëlimit të riskut dhe të planit të emergjencave

1.2 Procesi i përgatitjes së stragjisë së ZRF

Strategjia e ZRRF-së është dokumenti kryesor kornizë që udhëzon bashkinë për çështjet e mbrojtjes civile. Për këtë arsye duhet të hartohet me pjesëmarrje duke krijuar një bazë veprimi të përbashkët midis bashkisë dhe komunitetit.
Strategjia e ZRRF-së duhet të shihet si një strategji gjithëpërfshirëse e cila angazhon të gjithë sektorët e bashkisë. Prandaj, ishte e rëndësishme që gjatë fazës fillestare të rishikohen të gjitha strategjitë ose planet bashkiake, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: Planet e Përgjithshme Vendore Territoriale, Programet e Strehimit, Planet e Mbrojtjes Sociale, Strategjinë e Mjedisit, Planin e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Plani i Integrimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian., etj. Për të mbështetur procesin e rishikimit, janë bërë dhe intervista me stafin kyç bashkiak, si dhe me palët e interesit, në mënyrë që të kuptohen më mirë prioritetet e ndryshme. Përveç dokumenteve vendore, Strategjitë Kombëtare që fokusohen në ZRRF, Ndryshimet Klimatike, Mbrojtjen Sociale janë konsultur për të siguruar harmonizimin dhe integrimin.
Me përfundimin të fazës së rishikimit të dokumenteve ekzistuese, është bërë një workshop me AKMC-në, stafin e bashkisë, stafin e prefekturës, si dhe përfaqësues të firmave konsulente që kanë mbështetur bashkitë në qarkun e Fierit për përgatitjen e Vlerësimit të Riskut. Nëpërmjet këtij

aktiviteti u ndërtua një mirëkuptim i përbashkët midis të gjithë aktorëve mbi prioritetet dhe kontekstin në të cilin zhvillohen këto strategji.
Në kuadër të hartimit të strategjisë së ZRF-së është bërë një përmbledhje e gjetjeve kryesore nga dokumenti i vlerësimit të riskut miratuar në bashki, që përfshin:

- të dhënat kryesore të ekspozimit nga secili prej rreziqeve;
- përcaktimi i elementeve në rrezik bazuar në 5 shtylla: komponentët fizik; komponentët social; komponentët natyror; komponentët kulturor; komponentët ekonomik
- Cenueshmëria e 'komponentëve në rrezik' në nivelin të njësive administrative
- Vlerësimi i kapaciteteve lokale për përballimin, reagimin dhe parashikimin e rrezikut (në nivel qeverisjeje dhe shoqëror)
- Kalendarët sezonal dhe historik për secilin prej rreziqeve
- Vlerësimi i riskut për secilin nga rreziqet
- Një vështrim i risqeve të shumëfishta në territor

Nëpërmjet këtyre të dhënave selektohen projektet prioritare për bashkinë duke siguruar një qasje të bazuar mbi të dhëna.
Për ngritjen e Vizionit dhe Objektivave Strategjikë të Strategjisë Vendore të ZRRF-së janë ndërmarrë këto hapa:

- Vizionimi me pjesëmarrje dhe vendosja e objektivave me komunitetin përmes fokus grupeve
- Vizionimi me pjesëmarrje dhe vendosja e objektivave me AKMC-në dhe stafin e bashkisë

Përpara vizionimit me pjesëmarrje u zhvillua një analizë SWOT dhe Pema e Problemeve. Të dy këto instrumente ndihmojnë përfaqësuesit e stafit bashkiak dhe komunitetin të mendojnë në kontekstin shkak pasojë dhe ndikimet afatgjata të rreziqeve natyrore, për të arritur në objektiva realiste për zbutjen dhe zvogëlimin e riskut.
Artikulimi i objektivave strategjikë është në modalitetin 'SMART', pra krijimi i objektivave që janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realiste dhe të përcaktuara në kohë. Pasi të përcaktohen objektivat, detajohen masat përkatëse. Përsëri prioritizimi i masave është bërë përmes një procesi me pjesëmarrje me fokus grupe. Gjatë procesit të prioritarizimit janë marrë në konsideratë edhe aspektet financiare specifike të bashkisë.
Masat e hartuara janë integruar në një plan veprimi. Plani i veprimit përcakton periudhat e zbatimit, institucionet zbatuese/përgjegjëse, aktorët që duhet të përfshihen, rreziqet e zbatimit si dhe burimet e mundshme të financimit. Siç u përmend më parë, masat do të jenë strukturore (investime kapitale) si dhe jostrukturore (masa të buta).
Bashkangjitur me strategjinë janë integruar edhe çështjet e monitorimit dhe raportimit. Në funksion të tyre janë zhvilluar një sërë treguesish që synojnë të mbështesin bashkinë në monitorimin e situatës së ZRRF në baza vjetore si dhe në monitorimin e zbatimit të strategjisë. Treguesit e monitorimit shërbejnë edhe për qëllime të raportimit pranë institucioneve të tjera si prefektura dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Këta tregues bazohen në objektivat e monitorimit të Kuadrit SENDAI dhe lehtësojnë hartimin e planeve të emergjencës civile në fazën e mëvonshme.
Gjithashtu strategjia synon përmirësimin e përgjithsëm të kulturës dhe politikave të ZRF në të gjithë sektorët e bashkisë. Disa nga rekomandimet përfshinin rishikimin e politikave dhe rregulloreve të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit, rishikimin e politikave të planeve sektoriale si Trashëgimia Kulturore, Zhvillimi Ekonomik Vendor, Planet e Lëvizshmërisë, Planet e Mbrojtjes së Mjedisit etj. Vëmendje e veçantë i kushtohet zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe çështjeve të vulnerabilitetit dhe gjinisë.

1.3 Dokumentet Strategjike Kombëtare dhe Lokale

Duke ju refereruar ligjit nr. 45/2019 'Për mbrojtjen civile' neni 12, dokumenti i Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë, qoftë në nivel kombëtar qoftë në nivel vendor, ka prioritet ndaj strategjive apo planeve të tjera. Në fjalë të tjera, çdo dokument tjetër, në nivel qendror dhe vendor, duhet të jetë i harmonizuar me SZRF. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të kuptojmë dhe të evidentojmë këto dokumente që janë relevante për ZRF. Gjithashtu, SZRF vendore duhet të jetë në linjë me SZRF kombëtare për të siguruar një kohezion të mirë ndër-institucional dhe ndër-sektorial, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 (SKZRF) – është dokumenti kryesor në sektorin e mbrojtjes civile me anë të të cilit do të orjentohen aktivitetet dhe investimet e ardhsme të Shqipërisë për menaxhimin e riskut nga nga fatkeqësitë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke përfshirë parapërgatitjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe planifikimit të zhvillimit. Strategjia vendos disa objektiva strategjikë të cilët do të lejojnë më pas edhe zbatimin e saj e fokusuar në 5 element kryesorë: a) menaxhimi i risqeve ekzistuese dhe parandalimi i risqeve të rinj; b) rritja e ndërgjegjësimit, njohurive dhe shkëmbimit të informacionit lidhur me Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë (MRF) dhe MC me një vëmëndje të veçantë kundrejt personave me aftësi të kufizuara, barazisë gjinore dhe grupeve të tjera të cënueshme; c) rritja e kapaciteteve të përgjigjes dhe përfshirjes së inovacionit; d) harmonizimi i politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator të ZRF; e) përforcimi i aftësive menaxhuese të riskut nga fatkeqësitë me qëllim anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE).

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror 2022 (VKRF) – është një dokument i cili mbështet qeverinë shqiptare në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë me synimin për të dhënë informacion dhe njohuri mbi procset e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet grupeve kombëtare e ndërkombëtare si dhe adresimin e sfidave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ky dokument evidenton 8-të risqe potenciale për Shqipërinë të cilat janë: përmbytjet, rrëshqitjet, zjarret, tërmetet, riku teknologjik, risku biologjik, ortekët, dhe çarja e digave. Sipas vlerësimit, më problematikët shfaqen të jenë përmbytjet, risku teknologjik dhe ai biologjik. Nga analiza e ekspozimit nga risqet e shumëfishta, qarqet më të ekspozuara janë Tirana dhe Vlora (risk i lartë), Fieri, Elbasani, Shkodra dhe Durrësi (risk mesatar në të lartë). Vlerësimi sugjeron rritjen e kapaciteteve në tre drejtime kryesore: zbutjen e risqeve; hartimin e strategjisë për menaxhimin e fatkeqësive; ndërmarrja e vlerësimeve periodike në kontekstin e ZRF. Përsa i përket qarkut të Fierit, riskun më të lartë nga fatkeqësitë e përaqësojnë përmbytjet dhe risqet teknologjike.
Fushat e rëndësishme të ngritjes së kapaciteteve të MRF-së në këtë qark përfshijnë a) menaxhimin e riskut nga përmbytjet, b) menaxhimin e riskut nga zjarret masive dhe c) monitorimin dhe zbutjen e risqeve teknologjike.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushje, PPV, 2015 – 2030 – është dokumenti kryesor i planifikimit në nivel vendor i cili drejton zhvillimin e ekonomik, social e mjedisor të bashkisë Lushnje. Ne dokument evidentohet se koncepti i zhvillimit shkon përtej atij ekonomik duke synuar zbutjen e pabarazive sociale dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. PPV parashikon edhe disa objektiva strategjik: a)diversifikimi dhe bashkëjetesa e sektorëve të ndryshëm ekonomik; b) mbrojtja e tokës bujqësore dhe konsolidimi I saj; c)ruajtja dhe rehabilitimi I mejdisit natyror, ujor e bregdetar; d) projektimi i shtrirjes dhe densifikimi urban në përputhje me poppullsinë e pritshme dhe kapacitetin mbajtës të zonave; e) lidhja e mirë e territorit nëpërmjet akseve rugore e hekurudhore. Ndër të tjera ky dokument parashikon një sërë masash në kuadër të mbrojtjes së

burimeve natyrore dhe promovimit të zhvillimit të qendrueshëm të cilat janë në linjë me projektet e parashikuara në Strategjinë ZRF.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Bashkisë Lushnje, VSM, 2015-2030 – është hartuar në kuadër të hartimit të PPV Lushnje me qëllim sigurimin e masave mbrojtëse për mjedisin dhe zhvillimin e qendrueshëm duke u siguruar për përfshirjen e çështjeve mjedisore gjatë hartimit të PPV-së dhe adresimin e efekteve potenciale në fazat e ardhshme të vendim-marrjes lidhur me procesin e planifikimit. Gjatë hartimit të VSM janë caktuar një sërë objektivash mjedisorë të cilët synojnë të shërbejnë si udhëzues për zhvillimet e ardhshme duke përmendur këtu: monitorimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjes së burimeve ujore dhe minimizimi I efekteve negative nga aktiviteti njerëzor, mbrojtja dhe menaxhimi I qendrueshëm I tokës, Pyjeve, biodiversitetit, ekosisitemeve, peizazhit, trashigimisë kulturore dhe marrjen e masave për zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike

2. Konteksti i ZRF-ve bashkiake

2.1 Vlerësimi i riskut

Bashkia Lushnjë, me një sipërfaqe prej 372.72 km², përbëhet nga 11 njësi administrative të cilat janë: Lushnjë, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballagat, Fier Shegan, Kolonjë, Krutje. Kjo bashki kufizohet në veri me bashkitë Rrogozhinë dhe Peqin, në lindje me bashkinë e Divjakës, në jug me bashkitë e Fierit dhe Roskovecit dhe në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Lushnjës. Sa i përket numrit te përgjithshëm të popullsise sipas Censusit 2011 Bashkia Lushnje ka nje spopullsi prej 83 659 persona dhe nje dendësi prej 224 banorë/km2 ndërkohe sipas Gjendjes Civile numri i popullsisë është 130 494 dhe dendësia 350 banoë/km2. Aktiviteti primar ekonomik është bujqësia me 59.3%, industria zë 9.6% dhe Sherbimet kanë 31.2% të të punesuarvë në bashki.

Sa i përket stokut të banesave sipas Censusti 2011 dhe ASIG numri i përgjithshëm i banesave në bashkinë Lushnje është 23373. Sipas periudhës së ndërtimit të ndërtesave sasia me e vogël e ndërtimeve në bashki i përket ndërtimeve para vitit 1960 ndërkohë masa më e madhe e ndërtimeve në bashki janë ndërtuar në periudhën nga viti 1961-1990. Në NJA Lushnje ku edhe përqendrimi i ndërtimeve është më i madh ndodh krejt e kundërta ku sasia më e madhe e ndërtimeve është zhvilluar në priudhën pas 2011 që do të thotë që ndërtesat jane kryesisht të reja dhe jo te amortizuara.

Tabela 1: Mosha e ndërtimeve sipas NjA Bashkia Lushnje

Njësia administrative	Periudha e ndërtimit				
	Deri 1960	1961 - 1990	1991 - 2000	2001 - 2011	Pas 2011
ALLKAJ	85	357	421	320	278
BALLAGAT	142	458	84	126	57
BUBULLIMË	163	491	480	407	-
DUSHK	293	766	442	324	379
FIER SHEGAN	206	727	627	399	244
GOLEM	277	468	204	234	127
HYSGJOKAJ	91	308	98	123	213
KARBUNARË	252	623	206	225	27
KOLONJË	239	613	391	384	248
KRUTJE	181	700	642	519	254
LUSHNJË	1,101	2,111	1,115	758	2,365
Total	3,030	7,622	4,710	3,819	4,192

Burimi: INSTAT CENSUS 2011, Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Infrastrukturat kritike luajnë rol kryesor në përcaktimin e riskut nga fatkeqsitë natyrore dhe sit ë tilla në bashkinë Lushnje kemi 14 Diga, 8 Monumente Kulture, 13 Ura, 7 institucione shendetsore dhe 84 institucione arsimore.

Tabela 2: Infrastruktura kritike dhe publike në Bashkinë Lushnje

Njësia administrative	Monumente Kulture	Diga	Ura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor
ALLKAJ	1	0	0	0	5
BALLAGAT	0	3	0	1	4
BUBULLIMË	0	0	0	0	8
DUSHK	0	2	2	0	4
FIER SHEGAN	0	1	2	1	8
GOLEM	0	2	0	0	7
HYSGJOKAJ	0	3	0	0	4
KARBUNARË	2	3	2	0	9
KOLONJË	2	2	3	1	11
KRUTJE	2	0	0	1	14
LUSHNJË	1	0	4	3	19


Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Vlerësimi i Riskut nga Përmbytjet

Nga Metodologjia e vlerësimit të riskut për përmbytjet në bashkinë Lushnje vërehet që NjA Lushnje e cila përbën dhe numrin më të madh të popullsisë dhe NjA Allkaj janë NjA me riskun më të lartë për përmbtyje në raport me NjA-t e tjera.

Përmbtyjet janë ndër rreziqet me frekuente të cila prekin territorin e bashkisë Lushnje në këtë kuadër dokumenti i Vlerësimit të Riskut ka hartuar dy skenarë për përmbtyjet. Skenari i permbtyjeve me siguri 1 here në 100 vite dhe Skenari I përmbtyjeve nga Shkatërrimi I Digave.

Në skenarin e përmbtyjeve me siguri në 100 vite ndikimi ekonomik shkon në 17.3 mln euro dhe në bazë të PBB së qarkut. Ndikimi ekonomik është madhor ndërkohe probabiliteti është I ulët që të ndodhi. Nga ky skenar sa I përket popullsisë se ndikuarNjA Lunshje renditet e para me 777 banorë të prekur me pas ne renditje janë NjA Dushk dhe Fier Shegan. Sa i përket dëmit ekonomik përsëri NjA Lushnje është NJA që ndikohet më shumë e cila vlerësohet me 4.5 mln euro dëm. NjA-t e tjera renditen me pas NjA Allkaj me 2.3 mln euro, NjA Bubullimë me 1.99 mln, NjA Kolonjë me 1.98 mln si dhe NjA Krutje me 1.77mln euro ndërsa NjA-t e tjera kanë vlerësimet më të ulëta të dëmeve.



Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Skenari i përmbytjeve nga shkatërrimi digave vlerësohet si një skenar ku ndikimi është shkatërrimtar dhe dëmi ekonomik vlersohet ne 264, 549, 577euro por gjasat për të ndodhur janë shumë të rralla. Sa i përket popullsisë së ndikuar NjA më të prekura natyrisht janë NjA Lushnje, NjA Krutje, NjA Bubullimë dhe NjA Allkaj paraqiten si më të ndikuarat. Po ashtu sa i përket dëmit ekonomik NjA-t e lartpërmendura janë më problematiket.


Nga të dhënat e grumbulluara nga komuniteti Fshatrat Thanasaj, Halilaj, Imsht, Adrenicë dhe Gjonas janë zona te prekura nga përmbytjet kryesisht përmbytje që vijnë si rezultat i shirave të dendur që shkaktojnë fryerjen e përrenjve malor apo të rrezervuarit të thanës.

Vlerësimi i Riskut nga Rrëshqitjet

Ky rrezik natyror në bazë të morfologjisë së territorit është evident kryesisht në zonat kodrinore e malore të territorit. Në këtë pikpamje por edhe nga inventari i rrezikut nga rrëshqitjet vërehet se NjA-t më të prekura nga ky rrezik janë NjA-t Ballagat, Golem, Karbunare dhe Hyrgjokaj të cilat janë edhe zonat me territor më të ngritur në Bashkinë Lushnje. Nga inventari i fenomeneve të tilla raportohet se kanë ndodhur rreth 490 rreshqitje toke me një sipërfaqe prej 897.7 ha.

Risku nga rreshqitjet është llogaritur si rezultat i dy analizave atë të qendrueshmërisë së shpateve dhe të ndjeshmërisë të relievit të cilat kontribuojnë direkt në nivelin e riskut në kuader të rrëshqitjeve të tokës. Rezultatet e vlerësimit të riskut kanë dalë si rezultat i llogaritjeve për tre kategori ekspozimi: Veprat Insfrastrukturore, Monumentet dhe Trashëgimi Kulturore si dhe

Objekte Inxhinierike. Për katëgorinë A të ndikimit të rrëshqitjeve në vepra insfrastrukturore NjA Ballagat dhe Hysgjokaj ky risk vlerësohet si shumë i lartë, në NjA Karbunarë vlerësohet si i lartë, ndërsa në njësitë e tjera ky risk mungon ose është shumë i ulët. Për kategorinë B ndikimi i rrëshqitjeve në objektet e trashigimisë kulturore për NjA Ballagat dhe Karbunarë ky risk vlersohët si shumë i lartë, në NjA Golem, Kolonjë dhe Lushnje vlersohet si risk mesatar ndërkohë për NjA-t e tjera vlerësohet si një risk i munguar. Për kategorinë C të ndikimit të rrëshqitjeve në objektet inxhinierike vetëm në NJA Hysgjokaj kemi risk të mesën ndërkohë në NjA-t e tjera ky risk vlerësohet si i munguar.




Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Vlerësimi i Riskut Sizmik

Risku sizmik është një ndër risqet më problematike në përgjithësi si pasojë e faktorit të paparashikueshmërisë së eventeve të tilla. Vlerësimi i riskut si në çdo lloj rreziku tjetër vlerësohet duke analizuar rrezikun, ekspozimin, cenueshmerinë dhe kapacitet përballuese. Sa i peket rrezikut nga aktiviteti sizmik është marrë për bazë harta e probabilitetit të tejkalimit përkatësisht 10% në 10 vjet dhe 10% në 50 vjet. Gjithashtu hartat e koficientit zimik. Sa i përkët ekspozimit një element i rëndësishëm është vlersimi taksonomik i aseteve që kanë të bëjnë me periudhën e ndërtimit, lartësinë në kate, materialin kryesor ndërtimor si dhe faktorë të tjerë ndikues në modelin e ndërtimit etj. Elementët në ekspozim në këtë rast janë Ndërtesat, objektet shëndetsore, objektet arsimore, urat, objektet e trashigimisë kulturore dhe Digat.


Vlerësimi i Riskut për NjA-t e në lidhje me riskun sizmik është llogaritur si maksimumi i nivelit të riskut për secilin kriter (dëmi ekonomik dhe në njerëz) për secilin nga skenarët. Në këtë kuadër Riskun në NjA Lushnje vlersohet si shkatërrimtar me shkallën e riskut 9 kjo edhe nga përqenrimi i madh i ndërtimeve dhe vlërësimi i impaktit ekonomik. Njësitë më pak të riskuara janë NjA Ballagat dhe NjA Hysgjokaj.



Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Vlerësimi i Riskut Biologjik


Menaxhimi i riqeve të shkaktuara nga agjentët biologjik është një faktor mjaft i rëndësishëm i cili adresohet edhe globalisht si një ndër rreziqet e fatkeqsive natyrore kjo edhe si pasojë e pandemisë Covid-19 me të cilën edhe Shqipëria u përball. Si evente të cilat klasifikohen si rrezik biologjik mund të rendisim pandeminë Covid-19 e cila ka prekur Lushnjen me 257 humbje jete 1283 raste të rënda dhe 5183 raste të moderuara. Nga Gripi i rëndë sezonal kemi rreth 13 humbje jetësh në vit 180 raste të rënda dhe 10458 raste të moderuara. Si rreziqe evidentë janë dhe sëmundjet e fruthit dhe Antibiotiko-rezistenca Nga Analiza e vlerësimit të riskut në kuadër të këtij risku në përgjithësi NjAt vlerësohen me risk të nivelit 8 përveç NjA Ballagat dhe Hysgjokaj. Në këtë rast investimet kryesore duhet të orinetohen drejt kapaciteve përballuese të cilat duhet të rriten në mënyrë substanciale.



Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Vlerësimi i Riskut Teknoligjik

Fatkeqsitë teknologjike dhe për aktivitetet teknologjike/industriale klasifikohen si fatkeqsi që shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike por edhe njerzore nga mundshmëria e aksidenteve në vepra të mëdha industriale apo teknologjike. Në përgjithësi dëmtimi i këtyre veprave madhore shkakton humbje të madhe ekonomike dhe materiale dhe ndër fatkeqësi të tjera është edhe ajo e ndotjes së mjedisit. Si objekt në Bashkinë Lushnje kemi Vend-burimin e naftës në Patoz-Marinëz i cili shtrihet deri në Kallm-Bullullimë që përfshihet nga Bashkia Lushnje. Gjithashtu rrejti i tubacioneve që lidh zonën naftëmbajtëse dhe këto tubacione përgjithësisht nuk janë në gjendje të mirë teknike. Në bashkinë Lushnje kemi edhe aktivitet aktual të përpunimit të naftës nga Kompania Am-OIL si kompani rafineri kapaciteti I së cilës është në një sasi mbi 500 tonë naftë në ditë me një sasi 100000 deri në 1500000 ton naftë bruto në vit. Një faktor mjaft i rëndësishëm janë edhe pikat e karburanteve të cilat përbëjnë rrezik të mundëshëm teknologjik. Në bashkinë Lushnje ndodhen rreth 31 pika të tilla karburanti.
Sa i përkët furnizimit me ujë aksidente teknologjike në këtë sektor jetsor do të çonin në ndërpjerejen me furnizimin me ujë në bashki. Bashkia Lushnje fusnizon me ujë NjA-t Lushnje, Kolonjë, Allkaj,Fier-Shegan, Bubullimë, Dyshk dhe Krutje ndërkohë në NjA Ballagat, Hysgjokaj dhe Golem nuk ka furnizm me ujë nga ujsjellësi. Ndërmarrja e ujsjellësit ka rreth 7 pusshpime 10 km kanali primar dhe 58 km kanale shpërndarëse si dhe 19000m³në ditë. Nisur nga këto fakte Risku Teknologjik në NjA-t Bubullimë, Kolonjë dhe Lushje është më I lartë krahasuar me NjA-t e tjera.



Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Vlerësimi i Riskut nga Zjarret në pyje


Reziku i zjarreve në pyje është një rrezik I cili lidhet kryesisht me ekspozimin e zonave me vegjetacion të lartë ndaj temperaturave të larta të cilat shkaktojnë rënien e zjarreve në zona të caktuara.

Sipërfaqja e fondit pyjor të bashkisë Lushnje është rreth 956 ha dhe sipas kalendarit hitorik te eventeve të tilla nga periudha 2003 deri ne 2022 në bashki janë djegur rreth 66.93 ha pyje ku viti 2008 ka shënuar piken kulmore në të cilin janë rregjistruar 7 evente te tilla. Origjina e zjarreve në

të shumtën e rasteve rrezulton e panjohur jo nga kushte atmosferike shifër që le dyshime që shumica e zjarreve janë të shkaktuara ngadora e njeriut. Sa i përket dëmeve te shkaktuara nga zjarret NjA-t më të prekura janë Karbunara, Kolonja, Dushku dhe Lushnja ndërsa NjA-t e tjerajanë më pak të prekura. Në nivël fshatrash sa i përket popullsisë së prekur nga rreziku i rënies se zjarreve Fshatrat Karbunarë e Vogël, Kolonjë dhe Garunjas vleresohen zi zona me nivel te lartë risku.

Sa i përkët vlerësimit të propabilitetit të rënies së rjarreve në pyje në bashkinë Lushnje Vlerësohet se kemi pak gjasa(më pak se 1 zjarr në vit) që të ndodhë në këtë kuadër niveli i riskut është i papërfillshëm për jetën dhe shëndëtin e njeriut . Sa i përket ndikimit ekonomik dhe mjedisor zjarret janë vlerësuar që kanë ndikim nga të ulët deri në mesatar. Si rezultat i këtyre dy kritereve risku në nivel bashkie renditet në risk të mësëm në të ulët.

Nga të dhënat e grumbulluara nga komuniteti Në fshatrat Gjonas, Adrenicë dhe Thabasaj janë të impaktuar nga zjarret të cilët kryesisht shkaktohen nga shkaqe jo natyrore.



Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Vlerësimi i Shumfishtë i Riskut

Vlera e humbjeve mesatare vjetore për bashkinë Lushnjë (AAL-BL) rezulton 20.6% e AAL-QF. Vlera 100% AAL-BL është mbajtur si referencë në shpërndarjen e humbjeve mesatare vjetore për çdo njësi administrative të bashkisë Lushnjë.

Sa i përket humbjeve mesatare vjetore sipas llojit të riskut, risku sizmik me 35% paraqitet si risku me ndikimin më të madh në territor i cili ndiqet nga risku biologjik me 28.7%, risku teknologjik me 11.3%, risku nga rrëshqitjet në 9.64% dhe më pas renditen risku nga përmbytjet dhe i zjarreve në pyje të cilat paraqesin nivele me te ulëta ndikimi.





Tabela 3: % e riskut sipas llojit dhe sipas NjA ne Bashkinë Lushnje.

Bashkia	*Risku Biologjik*	*Risku nga Rrëshqitjet*	*Risku Sizmik*	*Risku nga Përmbytjet*	*Risku Tekonolgjik*	*Risku nga Zjarret në Pyje*	*Shuma*
ALLKAJ	1.48%	0.01%	2.17%	1.20%	0.47%	0.00%	**5.32%**
BALLAGAT	0.84%	1.39%	0.54%	0.18%	0.15%	0.19%	**3.31%**
BUBULLIMË	1.90%	0.00%	3.05%	1.01%	1.25%	0.01%	**7.23%**
DUSHK	2.70%	0.99%	2.22%	0.49%	0.92%	1.47%	**8.78%**
FIER SHEGAN	2.41%	0.35%	3.19%	0.63%	0.73%	0.34%	**7.65%**
GOLEM	1.80%	1.31%	2.44%	0.46%	0.93%	0.60%	**7.53%**
HYSGJOKAJ	0.89%	2.42%	0.62%	0.16%	0.18%	0.01%	**4.29%**
KARBUNARË	1.44%	1.91%	1.78%	0.45%	0.44%	1.47%	**7.49%**
KOLONJË	1.97%	0.89%	1.79%	1.00%	1.62%	1.47%	**8.74%**
KRUTJE	2.60%	0.00%	3.66%	0.90%	1.11%	0.04%	**8.31%**
LUSHNJË	10.67%	0.37%	13.51%	2.28%	3.54%	0.99%	**31.36%**
Shuma	**28.71%**	**9.64%**	**34.99%**	**8.76%**	**11.33%**	**6.58%**	

Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Krahas analizës së risqeve kryesore në territorin e bashkisë, raporti i përmbledhur i riskut paraqet gjithashtu analizën e risqeve grumbulluese të fatkeqësive për çdo njësi administrative të bashkisë.




Burimi: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqsive Bashkia Lushnje (2023)

Sipas analizës krahasuese të njësive administrative për risqet e paraqitura në gjashtë raportet e posaçme, njësia administrative më e ekspozuar ndaj fatkeqësive në territorin e bashkisë është njësia administrative Lushnjë, ndërsa ajo më pak e ekspozuar është njësia administrative Hysgjokaj.

2.2 Kapacitetet financiare të Bashkisë


Burimet financiare në dispozicion të bashkisë Lushnje paraqiten të luhatshme përgjatë periudhës në analizë. Në fund të vitit 2022, të burimet financiare në dispozicion të bashkisë Lushnje shënuan një nivel prej rreth 1.9 miliardë lekë, në rënie të lehtë me rreth 3% në terma vjetorë. Ngushtimi i burimeve financiare në dispozicion u përcaktua gjerësisht prej tkurrjes së nivelit të transfertave ndërqeveritare të cilat përbëjnë 81% të burimeve totale për vitin 2022. Në të kundërt, të ardhurat nga burimet e veta vendore, kontribuan pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të burimeve financiare por pa kundërbilancuar efektet negative të tkurrjes së të hyrave në transfertat ndërqeveritare. Në kategorinë e transfertave të kushtëzuara, përfshihet edhe transferta e kushtëzuar për emergjencat civile. Të ardhurat nga burimet e veta shënuan rritje në vitin 2022, nën efektin e rritjes se të ardhurave nga tarifat dhe të ardhura të tjera. Në të kundërt, të ardhurat nga taksat vendore shënuan rënie me rreth 7% në terma vjetorë (kryesisht, rënia e të hyrave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme).



Grafik 1. Ecuria e të ardhurave totale

Burimi: www.financatvendore.al dhe përpunime të autorëve


Shpenzimet e kryera nga bashkia Lushnje shënuan një nivel prej rreth 1.9 miliardë lekë në fund të vitit 2022, në rënie me rreth 4% në terma vjetorë. Sipas natyrës ekonomike, bashkia Lushnje përdori rreth 89% të burimeve financiare në dispozicion për vitin 2022 për mbulimin e shpenzimeve korrente, shpenzime personeli dhe operative dhe të tjera. Gjatë vitit 2022, kjo kategori shpenzimesh u zgjerua me rreth 11% në terma vjetorë. Investimet apo shpenzimet kapitale përfaqësuan rreth 11% të shpenzimeve totale dhe shënuan rënie me rreth 55% në terma vjetorë. Kjo vlerë përfshin investime të kryera me fonde të veta të bashkisë (nga burimet e veta vendore dhe me fonde të kushtëzuara).



Grafik 2. Përdorimi i burimeve financiare

Burimi: www.financatvendore.al dhe përpunime të autorëve

Në klasifikimin sipas funksioneve të qeverisjes, shpenzimet rezultojnë të jenë perqendruar në masën 36% në funksionin "mbrojtja sociale" dhe shënuan rritje me rreth 9% krahasuar me vitin e mëparshëm. Në funksionin "arsim", bashkia Lushnje shpenzoi rreth 16% të burimeve financiare në dispozicion, ndjekur nga 14% të tyre në funskionin "strehim dhe komoditete të komunitetit" dhe "shërbime të përgjithshme publike". Mesatarisht në tre vitet e fundit, bashkia Lushnje ka shpenzuar rreth 2% të buxhetit në dispozicion në fuksionin "rendi dhe siguria publike" ku janë të përfshira ndër të tjera shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, parandalimi dhe menaxhimi të fatkeqësive natyrore (emergjencat civile). Në fund të vitit 2022, bashkia Lushnje rriti shpenzimet në këtë funksion me rreth 7% krahasuar me një vit më parë.



Grafik 3. Shpenzimet sipas funksioneve


Burimi: www.financatvendore.al dhe përpunime të autorëve

Në financimin e shërbimit të emergjencave civile, bashkitë në Shqipëri përdorin disa burime: fonde të cilat vijnë si transfertë e kushtëzuar nga ministria përgjegjëse e linjës, fonde të parashikuara në buxhetin vjetor deri në masën 1% të tij dhe fonde të tjera nga burimeve të veta vendore. Bazuar në ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", bashkitë kanë në drejtë të përftojnë një fond për për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile (fond i cili vjen si një transfertë e kushtëzuar). Bazuar në këtë ligj, specifikisht neni 65 parashikon që *"bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit."* Për vitin 2022 u parashikua alokimi i një fondi prej rreth 1 miliardë lekë për 61 bashkitë në vend dhe ndarë bashkive duke përdorusr si kriter peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive.

Për vitin 2022, bashkia Lushnje vlerësohet të ketë patur në dispozicion rreth 2% të këtij fondi. Nisur nga niveli aktual i shpenzimeve për funksionin "rendi dhe siguria publike", vlerësohet se bashkia Lushnje me përodrimin e fondit të kushtëzuar ka përmirësuar ofrimin e këtij shërbimi për

komunitetin. Për vitin 2023, bashkia Lushnje parashikoi alokimin e një fondi prej rreth 27 milionë lekë për programin "mbrojtja civile".[1]

Krahas fondeve të kushtëzuara, bashkitë duhet të planifikojnë në buxhetin vjetor, fonde për mbrojtjen civile deri në 1% të buxhetit të tyre.[2]



Grafik 4. Transferta e kushtëzuar nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" (viti 2022)
Burimi: https://arkiva.financa.gov.al/ dhe përpunime të autorëve

2.3 Donatorë, projekte, programe dhe mundësi të tjera financimi

Programe të AKMC: AKMC çdo vit hap thirrje për projekte nga bashkitë në fushën e mbrojtjes civile. Të gjitha bashkitë e territorit të Shqipërisë mund të aplikojnë për financimin e projekteve të ndryshme. Gjithashtu, AKMC në vitin 2024 ka hapur dhe një program të ri e të fokusuar në Diga. Kjo është një nismë e shkëlqyer edhe për bashkitë e Qarkut Fier duke marrë në konsideratë digat e ndryshme që gjenden në territorin e tyre si dhe nevojën imediate për ndërhyrje.
IPA South Adriatic: Programi ndërkufitar midis Shqipërisë – Italisë dhe Malit të Zi ofron mundësi të mira për bashkitë në të gjithë territorin e Shqipërisë për të qënë pjesë e projekteve dhe partneriteteve me institucione nga dy vendet e tjera pjesë e programit. Programi për periudhën 2021-2027 ka një buxhet total prej 81.258.768,19 Euro. Pjesë e aksioneve prioritare të programit është dhe prioriteti 2 i cili synon të promovojë Agjendën e Gjelbër për Adriatikun Jugor. Objektivi Strategjik 2.1 është drejtpërdrejtë i fokusuar tek përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive. Gjithashtu, prioriteti 2 ka të alokuar dhe pjesën më të madhe të buxhetit të programit, përkatësisht çka nënkupton mundësi të mira për bashkitë për të avancuar

[1] Burimi: Bashkia Lushnje, Dokumenti i Buxhetit 2023 i disponueshëm pranë: https://www.fvv.al/budget?years=34
[2] Burimi: Shkresë dërguar Bashkive, Thesarit dhe Këshillit të Qarkut nga Drejtoria e Financave Vendore 22/12/2021, prot. nr. 23026.

agjendat e tyre në zvogëlimin e riskut. Në kuadër të këtij program priten të hapen dhe dy thirrje për projekte, një thirrje e cila do të hapet në vitin 2024 për projekte standarte dhe një thirrje e pritshme të hapet në vitin 2025 për projekte në shkallë të vogël. Kjo do të thotë që bashkitë e Qarkut Fier, të cilat janë të lejuara të aplikojnë për këto projekte, kanë mundësi të mira për të jetësuar disa nga masat e strategjive nëpërmjet këtyre thirrje. Është e rëndësishme që të kihet parasysh norma e bashkë-financimit e cila për projekte të tilla është minimumi 15%.

INTERREG Adrion: Është një tjetër program i rëndësishëm ku bashkitë e Qarkut Fier mund të marrin pjesë duke u bashkuar në partneritete të ndryshme në përgjigjie të thirrjeve përkatëse. Në krahasim me programet ndërkufitare, INTERREG është më kompleks pasi kërkon partneritete më të zgjeruara dhe një kapacitet më të lartë institucional, gjithësesi, kjo nuk do të thotë që bashkitë nuk mund të aplikojnë apo nuk mund të lobojnë për të qënë pjesë e projekteve të ndryshme. Projektet janë të natyrave të ndryshme dhe përfshijnë si aktivitete për ngritje kapacitetesh ashtu edhe projekte të cilat synojnë ndërhyrje pilot. Në ngjashmëri me IPA South Adriatic, edhe në këtë rast, prioriteti 2 fokusohet tek Tranzicioni i Gjelbër, dhe veçanërisht objektivi 2.1 fokusohet tek rritja e aftësisë ripërtëritëse, ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive.

INTERREG Euro-MED: Është një ndër programet më të rëndësishme të BE për bashkëpunimin ndër-rajonal. Ky program përfshin të gjitha vendet e Mesdheut dhe ka një buxhet mbi 290 milion Euro. Prioriteti 2 i programit "Mesdheu i Gjelbër", fokusohet tek ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i riskut. Ashtu si INTERREG Adrion është një program kompleks por sërish bashkitë e Qarkut Fier mund të bëhen pjesë e partneriteteve të ndryshme. Parashikohen që të hapen thirrje për projekte në gjysmën e dytë të vitit 2024 dhe dy thirrje të tjera në vitin 2026, çka përbëjnë një mundësi të mirë për bashkitë për tu angazhuar në gjetjen e partnerëve dhe aplikimin për projekte të ndryshme. Fakti që bashkitë e Qarkut Fier do të kenë një Strategji të miratuar për Zvogëlimin e Riskut është një avantazh për të konkuruar dhe bërë pjesë e partneriteteve.

INTERREG Balkan-Med: Është një program relativisht i ri i BE i cili synon të mbështesë vendet e Ballkanit në Mesdhe. Shqipëria si pjesë e vendeve të cilat synojnë të futen në BE është pjesë e këtij programi dhe në të mund të aplikojnë për projekte bashki dhe institucione nga i gjithë territori. Ky program ka një buxhet më të reduktuar krahasimisht me Euro-MED por është një mundësi e mirë për bashkitë dukeqënëse konkurenca është më e vogël në krahasim me programin tjetër. Edhe në këtë rast, prioriteti 2 i cili fokusohet tek mjedisi ka objektiva të dedikuar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.

Horizon Europe: Është programi më i madh i Bashkimit Europian i cili financon kërkimin shkencor në fusha të ndryshme. Ky është një program shumë ambicioz dhe relativisht i vështirë për bashkitë që të bëhen pjesë. Gjithësesi, një mundësi e mirë në këtë rast është bashkëpunimi i bashkive të Qarkut Fier me institucione akademike e kërkimore në mënyrë që të futen në partneritet për të konkuruar. Kuptohet që duke qënë një program me një fokus kryesor në kërkim shkencor dhe inovacion roli i bashkive mund të jetë kryesisht në formën e pilotimit të nismave të ndryshme dhe ngritjen e kapaciteteve. Veçanërisht në këtë kuadër janë të rëndësishme nisma nën ombrellën e BAUHAUS.

DG-ECHO: Është Departamenti i Komisionit Europian për Mbrojtjen Civile dhe Ndihmën e Operacionet Humanitare. Shpesh, DG-Echo hap thirrje të ndryshme të cilat synojnë mbështetjen në rritjen e kapaciteteve apo të projekteve për përshtatjen për zvogëlimin e riskut. Në këtë rast, dukeqënëse Shqipëria është pjesë e Mekanizmit Europian të Mbrojtjes Civile, bashkitë kanë të drejtë që të jenë pjesëmarrëse në projekte. Gjithësesi, strategjikisht do të ishte mirë që bashkitë të koordinohen me AKMC në mënyrë që të jenë pjesë e projekt aplikimeve të përbashketa. Bashkitë e Qarkut Fier duke pasur të hartuara Strategjitë e Zvogëlimit të Riskut kanë një avantazh konkurues ndaj bashkive të tjera. Po ashtu, programet e DG-ECHO janë shumë të rëndësishme për të ofruar trajnime e mbështetje në rritjen e kapaciteteve.

IADSA: është programi për Shkëmbimin e Borxhit midis Qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare. Në këtë program, bazuar në thirrje të ndryshme, bashkitë kanë të drejtë që të aplikojnë me projekte.

Pjesë e prioriteteve të këtij programi është dhe mbështetja e bashkive për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike etj. Bashkitë në përgjithësi kanë eksperience me këtë program dhe mund të aplikojnë sipas thirrjeve të ndryshme.

Agjenci Zhvillimi Ndërkombëtare dhe Donatorë: Agjenci të ndryshme zhvillimi ndërkombëtare operojnë në Shqipëri prej vitesh si UNDP, GIZ, SIDA, SDC, JICA etj të cilat në programet e tyre synojnë edhe përmirësimin e kushteve të mjedisit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e riskut. Mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet ndihmës së drejtpërdrejtë, ku bashkitë përzgjidhen nga vetë institucionet për mbështetje ose nëpërmjet aplikimeve apo granteve konkuruese. Bashkitë duhet të jenë të kujdesshme për të aplikuar në projekte të tilla ose për të lobuar për tu bërë pjesë e mbështetjes që ofrohet nga këto institucione. Gjithashtu, bashkitë duhet të koordinojnë me OSHC të cilat operojnë në territorin e tyre për ti orientuar që projektet të jenë në sinergji me objektivat strategjike e zhvillimore të bashkive.

3. Vizioni, Synimi dhe Objektivat Strategjike

Vizioni i Strategjisë Vendore të ZRF në bashkinë Lushnje , shkon përtej kohëzgjatjes së kësaj strategjie dhe synon të udhëzojë vendimarrësit dhe politikat lokale e sektroiale për marrjen e masave për parandalimin, përgatitjen, përgjigjen dhe rimëkëmbjen e shpejtë ndaj fatkeqësive natyrore. Nga ana tjetër vizioni vendos në fokusin e saj komunitetin dhe ndërveprimin e tij me autoritetet vendore si dy aktorët kryesor të cilët mund të marrin masa për parandalimin e risqeve në nivel vendor.

Vizioni

Bashkia Lushnje një bashki e aftë për të përballuar, parandaluar dhe zvogëluar riskun nga fatkeqësitë natyrore në territorin e saj duke rritur mundesine për të financuar projekte për mbrojtjen e sektorit ekonomik lokal, ruajten e resurseve natyrore dhe trashigimisë kulturore në kuader te rritjes e aftësisë ripërtëritëse në territor. Një bashki në të cilën komuniteti luan rol të rëndësishëm në përballimin fatkeqsive, duke qenë aktiv në ndërveprimin institucional për përballimin e tyre në mënyrë të integruar, në harmoni me politikat e tjera të zhvillimit të territorit dhe në bashkërendim me bashkitë e tjera të qarkut Fier.

Misioni

Të zhvillojë një bashkëpunim proaktiv dhe koordinim të qendrueshëm ndërsektorial duke përfshire edhe rolin e komunitetit për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në territorin e Bashkisë Lushnje.Të forcojë aftësinë riërtëritëse ne nivel lokal orinentuar drejt menaxhimit tër riskut duke zhvilluar struktura të afta për të përballuar emergjencat civile ne mbrojtje të gjithe grupeve sociale duke u udhëhequr nga parimi i barazisë.

Në përputhje me vizionin dhe misionin e përgjithshëm të strategjisë së ZRF, me parimet e kuadrit SENDAI, dhe me ciklin e menaxhimit të fatkeqësive, bashkia Lushnje ka hartuar objektivat strategjike e mëposhtme:

OS1 – Rritja e kapaciteteve teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF

OS2 – Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet vulnerabël dhe githëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive

OS3 – Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë

4. Projektet dhe Masat Strategjike

4.1 Masat Institucionale dhe Zhvillimi i Kapaciteteve

OS1	*Rritja e kapaciteteve administrative, teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF*
PS1.1	**Forcimi i kapaciteteve financiare dhe menaxheriale të bashkisë për ZRF**

Përshkrim

Ky projekt strategjik zhvillon më tej mekanizmat financiarë duke përmirësuar proceset e shpërndarjes se fondeve. Me anë të këtij projekti bashkia synon të përmirësojë aftësinë e saj për të financuar dhe zbatuar iniciativa që synojnë zvogëlimin e cenueshmërisë ndaj fatkeqësive natyrore dhe rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M1.1.1	Trajnimi i stafit për menaxhimin financiar dhe kushtet ligjore që vijne nga niveli Kombëtar (implmentimi i plotë i transfertes se kushtëzuar nga AKMC dhe inistiativat e tjera)	Masë jo-strukturore	Nr. i trajnimeve të kryera; Nr. i stafit të trajnuar
M1.1.2	Identifikimi dhe ngritja e një rrejti aktorësh me mundësi financimi per ndërmarrjen e inisiativave te ndryshme ne kuadër të ZRF	Masë administrative dhe organizative	Listë me aktorët e identifikuar
M1.1.3	Kërkimi/aplikimi për grante për financimin e projekteve te cilat adresojnë ZRF	Masë administrative dhe organizative	Nr. i aplikimeve për projekte që lidhen me ZRF
M1.1.4	Vendosja e taksave/Tarifave Vendore te përkohshme për adresimin e masave për parandalimin e rreziqeve	Masë administrative dhe organizative	Tarifa e vendosur
M1.1.5	Hartimi i një plani buxhetor disa vjecar me qellim realizimin e projekteve ne kuadër të ZRF duke qene pjese integrale e dokumentit të PBA të bashkisë Lushnje	Masë administrative dhe organizative	Plani buxhetor për ZRF
M1.1.6	Parashikimi në buxhet për incentivimin monetar të grupit të vullnetareve	Masë jo-strukturore	Plani buxhetor për ZRF (vulnetarët)
M1.1.7	Parashikimi buxhetor për siguracionin e aseteve dhe burimeëve njerzore të MZSH të bashkisë	Masë jo-strukturore	Nr. i aseteve të siguruara dhe I nr I stafit të siguruar
Kosto Totale			

Kohëzgjatja	

OS1	*Rritja e kapaciteteve administrative, teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF*
PS1.2	**Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të stafit komunal për ZRF**

Përshkrim

Ky projekt fokusohet në rritjen e aftësive administrative dhe teknike të stafit bashkiak për të menaxhuar në mënyrë efektive përpjekjet për ZRF. Përmes programeve të ndryshme të trajnimit, dhe iniciativave për ngritjen e kapaciteteve, projekti synon të pajisë stafin bashkiak me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të adresuar sfidat e ZRF në mënyrë proaktive.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M1.2.1	Shtimi i personelit te MZSH me 6 persona	Masë administrative dhe organizative	Nurmri I shtuar I punonjësve të bashkisë
M1.2.2	Zhvillimi i një fushate rekrutimi afatgjate për zëvendesimin e plotë të stafit të MZSH me moshë të re pune.	Masë administrative dhe organizative	Numri I punonjësvë të zëvendësuar në repartin e MZSH
M1.2.3	Trajnimi I vazhdueshëm I stafit nga Institucionet kompetente ne lidhje me aspekte të ndryshme (mirëmbajtja e databazës GIS dhe Project cycle management në lidhje me thirrjet për projekte të emrgjencave civile).	Masë jo-strukturore	Numëri I trajnimeve dhe numri I stafit të trajnuar
M1.2.4	Rishikimi i PPV-së, strategjive dhe planeve sektoriale me fokus përshtatjen me ZRF	Masë administrative dhe organizative	Numri I dokumentave strategjik te rishikuar në kuadër të ZRF
M1.2.5	Plotësimi dhe përditësimi i databazës së standartizuar të dukurive të fatkeqsive natyrore dhe vleresimit te riskut në Bashkinë Lushnje.	Masë administrative dhe organizative	Numri i raportimve mujore tek AKMC dhe popullimi I saj me të dhëna
M1.2.6	Formalizimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet sektorit të mbrojtjes civile në bashki dhe atij në qark	Masë administrative dhe organizative	Numri I kanalve te komunikimit dhe funksionimi i tyre
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS1	Rritja e kapaciteteve administrative, teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF
PS1.3	**Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave në bashkisë**

Përshkrim			
Ky projekt i dedikohet forcimit të kapaciteteve të gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave në bashki. Nëpërmjet pajisjes së bashkisë me mjetet e nevojshme, hatimit të planeve të emergjancave dhe të evakuimit, projekti synon të rrisë aftësinë e bashkisë për të parashikuar, përgatitur dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive llojeve të ndryshme të emergjencave.			
Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M1.3.1	Hartëzimi i historikut të fatkeqsive dhe i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqsitë në sistemin GIS	Masë administrative dhe organizative	File GIS për ZRF
M1.3.2	Përditësimi dhe hartimi i planit të evakuimit në ndërtesat të cilat janë asete të bashkisë(objekte te administrates vendore, shkolla, çerdhe kopshte dhe objekte te nivelit parësorë shëndetsor)	Masë jo-strukturore	Nr i institucioneve ne pronësë të bashkisë dhe nr PEC i hartuar
M1.3.3	Pajisja e ndërtesave publike në pronësi të bashkisë (objekte të administrates vendore, shkolla, çerdhe kopshte dhe objekte te nivelit parësorë shëndetsor) me sistemet e sigurisë për përballimin e emergjencave civile.	Masë strukturore	Nr. i institucioneve në varësi të bashkisë të pajisura me sisteme sigurie në ndërtesa
M1.3.4	Pajisja e stafit me mjetet e nevojshme logjistike/kancelarike (pajisje teknologjike dhe orendi) per funksionimin normal te zyrës.	Masë strukturore	Përditësimi i vazhdueshëm i inventarit
M1.3.5	Blerja e 2 makinave teknologjike per emergjencat civile dhe repartin e MZSH (makine 4x4 për levizje ne terrene te vështira dhe makinë zjarrfikëse me shkallë me depozitë 3000 l ujë)	Masë strukturore	Numri i makinave të blera
M1.3.6	Blerje e pajisjeve ndihmëse për operacionet e MZSH (këmbaleca, ganxha, shkallë hedhëse,litar përloni me kapacitet mbajtës 300 kg, kostume për mdërhyrje speciale nga 8 copë për artikull)	Masë strukturore	Numri I pajisjeve ndihmëse të blera
M1.3.7	Blerje pajisjesh teknologjike për ndërhyjet e specializuara të MZSH (Elektor kompresor 1 copë, Aparate frymarrje AP3 4 copë, Pajisje kundra-gaz 4 copë, Gjenerator me vaj, Hapës pneumatik, Tobo hedhëse uji profesionale, Shkumë AFFF3% 1000 litër, Hedhëse uji profesionale Fi 50 mm)	Masë strukturore	Numri I pajisjeve teknologjike të blera
M1.3.8	Pilotimi dhe implementimi i sistemeve të alarmit të hershëm në linjë me SKZRF	Masë strukturore	Sistemi i alarmit te hershëm pjesërisht i ngritur
M1.3.9	Ngritja e 1 depoje dhe Plotesimi I rezervave ushqimore dhe bazës materiale për dhënien ne ndihmës në rast emergjence	Masë strukturore	Blerja e e 50-100 set pako ushqime batanije dhe çadra
Kosto Totale			

Kohëzgjatja	

OS1	Rritja e kapaciteteve administrative, teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF
PS1.4	**Projekte ndërkufitare në nivel vendor për ZRF**
Përshkrim Ky projekt fokusohet në promovimin e nismave ndërkufitare në nivel lokal për të rritur përpjekjet për ZRF. Nëpërmjet organizimit të konferencave ku përfshihen aktorë të ndryshëm dhe vendosjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekti synon të lehtësojë shkëmbimin e njohurive, koordinimin dhe veprimin e përbashkët për çështjet e ZRF.	

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M1.4.1	Organizimi i konferencave të donatorëve për ZRF ne nivel Qarku	Masë jo-strukturore	Nr. i konferencave te organizuara; Nr. i pjesëmarrësve
M1.4.2	Kriijimi i një databaze me donatoët dhe OSHC potenciale për ofrimin e projekteve ne kuadër të ZRF dhe përditësimi i saj rast pas rasti	Masë administrative dhe organizative	Marrëveshja e bashkëpunimit
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS2	*Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet më të cënueshme dhe githëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë*
PS2.1	**Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit mbi ZRF**
Përshkrim Ky projekt fokusohet në ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit për ZRF. Nëpërmjet fushatave informuese, dhe trajnimeve, projekti synon të rrisë njohuritë mbi rrisqet nga fatkeqësitë, mbi masat parapërgatitore dhe mbi strategjitë për zvogëlimin e cënueshmërisë të komunitetit dhe palëve të interesit.	

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M2.1.1	Hartimi dhe aprovimi i moduleve/protokolleve të unifikuara të trajnimit të grupeve të interesit në bashkëpunim me AKMC	Masë administrative dhe organizative	Moduli/protokolli i trajnimit
M2.1.2	Hartimi dhe aprovimi i një kalendari për zhvillimin e seminareve me grupet e interesit	Masë administrative dhe organizative	Kalendari
M2.1.3	Rritja e bashkëpunimit me TV dhe Radio lokale të cilat mund të shërbejnë për njoftimin e popullatës në rast fatkeqësie	Masë administrative dhe organizative	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit
M2.1.4	Përdorimi i rrjeteve sociale të bashkisë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për paralajmërimin në rast fatkeqësishë	Masë administrative dhe organizative	Nr. i postimeve për ZRF

M2.1.5	Zhvillimi i trajnimeve me qytetarët e grup-moshave të ndryshme, me fokus ZRF, të tilla si: - Trajnimi i qytetarëve mbi risqe specifike në nivel Njësie Administrative (trajnimi i banorëve në rast përmbytje fshatrat Toshkëz dhe Thanasaj, trajnimi I banorëve në rast zjarri fshati Zhamë) - Trajnimi i komunitetit mbi pastrimin e kanaleve tretësore - Trajnimi i komunitetit mbi menaxhimin e ekonomive pyjore - Trajnim i komunitetit për shërbimet e ekosistemit me fokus shkollat 9 vjeçare dhe të mesme - Trajnimi i kryepleqve të fshatrave për të rritur kapacitetet e tyre në lidhje me ZRF	Masë jo-strukturore	Nr. i trajnimeve të zhvilluara; Nr. i qytetarëve të trajnuar; Nr. i kryepleqëve të trajnuar
M2.1.6	Zhvillimi i fushatave informuese derë më derë *Përshkrim - fokusi janë zonat e ekspozuara ndaj risqeve, për të informuar qytetarët për procedurat të cilat duhet të ndiqen në rast fatkeqësie*	Masë jo-strukturore	Nr. i familjeve të informuara
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS2	*Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet më të cënueshme dhe githëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë*
PS2.2	**Ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vurnerabël dhe grave**

Përshkrim

Ky projekt i dedikohet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi ZRF i përshtatur posaçërisht për grupet vulnerabël dhe gratë. Nëpërmjet trajnimeve të ndryshme dhe fushatave informuese synohet pajisja e këtyre komuniteteve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar dhe për t'iu përgjigjur fatkeqësive në mënyrë efektive. Gjithashtu, duke fuqizuar grupet vulnerabël dhe gratë për çështje që lidhen me ZRF, projekti synon të rrisë pjesëmarrjen e tyre në përpjekjet për përgatitjen dhe reagimin ndaj fatkeqësive.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M2.2.1	Zhvillimi i seanca praktike trajnimi mbi ndihmën e parë, procedurat e evakuimit nga ndërtesat publike e private me fokus të veçantë tek gratë dhe grupet vulnerabël	Masë jo-strukturore	Nr. i trajnimeve; Nr. i pjesëmarrësve
M2.2.2	Zhvillimi i fushatave specifike ndërgjegjësuese për ZRF të cilat targetojnë grupet vulnerabël dhe gratë	Masë jo-strukturore	Nr. i fushatave të zhvilluara
M2.2.3	Zhvillimi i trajnimeve të evakuimit me komunitetin Rom dhe Egjiptian në zonat informale	Masë jo-strukturore	Nr. i trajnimeve; Nr. i pjesëmarrësve

Kosto Totale	
Kohëzgjatja	

OS2	*Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet më të cënueshme dhe githëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë*
PS2.3	**Konsolidimi dhe tajnimi i grupeve vullnetare në bashki në kuadër të ZRF**

Përshkrim

Ky projekt fokusohet në konsolidimin dhe ofrimin e trajnimeve për grupet vullnetare brenda bashkive për të rritur përpjekjet për ZRF. Nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, projekti synon të fuqizojë grupet vullnetare me njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të kontribuar efektivisht në aktivitetet e ZRF-së. Duke nxitur bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet grupeve vullnetare, projekti kërkon të shfrytëzojë fuqitë dhe burimet e tyre kolektive për të përmirësuar qëndrueshmërinë e komunitetit dhe aftësitë e reagimit.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M2.3.1	Ngritja e një baze digjitale të dhënash për regjistrimin e grupeve vullnetare për ZRF	Masë administrative dhe organizative	Regjistri digjital i vulnetarëve
M2.3.2	Trajnimi i grupeve vullnetare mbi ZRF në koordinim me modulet e përgatitura nga AKMC	Masë jo-strukturore	Nr. i trajnimeve; Nr. i pjesëmarrësve
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS3	*Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë*
PS3.1	**Rritja e gatishmërisë dhe kapaciteteve parandaluese ndaj përmbytjeve**

Përshkrim

Ky projekt fokusohet në rritjes së gatishmërisë dhe kapaciteteve parandaluese ndaj përmbytjeve brenda territorit të bashkisë. Nëpërmjet një kombinimi të vlerësimeve të rrezikut, përmirësimeve të infrastrukturës dhe kapacitimit me mjetet e nevojshme, projekti synon të rrisë aftësinë e bashkisë për të menaxhuar riskun nga përmbytjet.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M3.1.1	Hartimi i një protokolli të standardizuar dhe monitorimi i vazhdueshëm i kanaleve kulluese dhe vaditëse në pronësi të bashkisë	Masë administrative dhe organizative	Protokolli i monitorimit
M3.1.2	Monitorimi periodik i kanaleve parësore (në pronësi të bashkisë), dytësore dhe tretësore duke u bazuar në një kalendar të unifikuar (sektori i mbrojtjes civile, drejtoria e bujqësisë, bordi i kullimit dhe ujitjes).	Masë administrative dhe organizative	Kalendari i monitorimit; Raporti i monitorimit
M3.1.3	Monitorimi dhe Vlerësimi i gjendjes së argjinaturave të lumit Shkumbin dhe Seman evidentimi I ndërhyrjeve të reja ne	Masë administrative dhe organizative	Raporti i monitorimit

	skapate dhe zonave per mbushjen e argjinaturave		
M3.1.4	Hartimi i pashaportës së gjendjes së rezervuarëve dhe digave në pronësi të bashkisë	Masë administrative dhe organizative	Pasaporta për çdo rezervuarë dhe digë
M3.1.5	Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të para të dyta dhe të treta në pronësi të bashkisë nga bashkia në bashkëpunim me komunitetin.	Masë Strukturore	Km të pastruara kanale dhe te mirëmbajtura
M3.1.6	Studimi i thelluar i gjendjes teknike të 21 digave të rrezervuareve në Bashkinë Lushnje	Masë jo-strukturore	Vlerësimi teknik për çdo digë dhe rezervuarë
M3.1.7	Përmirësimi i gjendjes së digave dhe rezervuarëve në pronësi të bashkisë sipas vlerësimit	Masë strukturore	Projekte në bazë të studimit; Ndërhyrje në bazë të studimit
M3.1.8	Rehabilitimi i rezervuarit të Kasharajt	Masë strukturore	Investimi I realizuar në Kasharaj
M3.1.9	Hartimi i Planit të Evakuimit nga Përmbytjet në Fshatrat Thanasaj dhe Toshkëz	Masë Jo Strukturore	Dy Plane evakuimi
M3.1.10	Blerja e pajisjeve për pastrimin e kanaleve, një eskavator me kolonë të gjatë dhe një eskavator me goma i përshtatshëm për të lëvizur në asfalt.	Masë strukturore	Faturat për blerjen e pajisjeve; Pajisjet
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS3	*Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për te marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë*
PS3.2	**Zvogëlimi, zbutja e pasojave të mundshme negative të rrëshqitjeve**

Përshkrim

Ky projekt fokusohet në reduktimin dhe zbutjen e pasojave të mundshme negative të rrëshqitjeve të dheut. Nëpërmjet vlerësimeve gjithëpërfshirëse të riskut, analizave të terrenit dhe ndërhyrjeve inxhinierike, projekti synon të identifikojë zonat e prirura për rrëshqitje dheu dhe të zbatojë masa për të minimizuar ndikimin e tyre.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M3.2.1	Studimi gjeologjik dhe monitorim i zonave me rrezik rrëshqitje me prioritet zonat kodrinore të Hysgjokajt dhe Ballagatit.	Masë jo-strukturore	Studim mbi rrëshqitjet

M3.2.2	Marrja e masave për stabilizimin e rrëshqitjeve bazuar në studime (prioritet zona e NjA-ve Ballagat dhe Hysgjokaj)	Masë strukturore	Projekte për rrëshqitjet; Ndërhyrje për rrëshqitjet
M3.2.3	Studim mbi largimin e Shkëmbinjve/ Gurëve me rrezik	Masë jo-strukturore	Studim mbi largimin e gurëve
M3.2.4	Marrja e masave për largimin e shkëmbinjve dhe gurrëve me rrezik bazuar në studime	Masë strukturore	Projekte për largimin e gurëve; Ndërhyrje për largimin e gurëve
M3.2.5	Implementimi i masave mbrojtëse nga rrëshqitjet në rrugën qe lidh fshatin Kasharaj me Qytetin e Lushnjes	Masë Strukturore	Kryerja e Investimit
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS3	*Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë*
PS3.3	**Parandalimi dhe përmirësimi i menaxhimit të riskut nga zjarri**

Përshkrim

Ky projekt synon të përforcojë dhe përmirësojë menaxhimin e riskut nga zjarri brenda territorit te bashkisë. Nëpërmjet një hartimit të planeve të menaxhimit të ekonomive pyjore, përmirësimin e aksesueshmërisë dhe përmirësimit të infrastrukturës reaguese, projekti synon të reduktojë gjasat dhe ashpërsinë e zjarreve.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M3.3.1	Hapja e rrugëve apo korridoreve pyjore me prioritet në zonën e Fshatit Zhamë sidhe në NjA Hysgjokaj Ballagat.	Masë strukturore	Nr. i rrugëve të hapura
M3.3.2	Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullusor	Masë administrative dhe organizative	Plani i masave
M3.3.3	Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga zjarret ndër vite me prioritet zonën e Zhamës (30 ha)	Masë strukturore	Sipërfaqjet e ripyllëzuara
M3.3.4	Përgatitja e planeve për menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve per 4 ekonomitë pyjore në administrim nga Bashkia	Masë jo-strukturore	Plani i menaxhimit te qendrueshëm të pyjeve i hartuar
M.3.3.5	Vendosja dhe furnizimi i hidranteve në qendrat e Njësive administrative NjA Ballagat, Hysgjokaj, Dushk, Karbunarë dhe Fier Shegan	Masë Strukturore	Implementimi i ndërhyrjes numri i hidrantëve të vënë
M3.3.6	Ndërtimi i një rrjeti pikash të reagimit të shpejtë për zjarret në afrësi të zonës pyjore	Masë strukturore	Nr. i pikave të reagimit të ngritura

M3.3.7	Ndërtimi i një rrjeti kullash vrojtimi në funksion të ngritjes së alarmit në rast zjarri (minimum 4, 1 përsecilen ekonomi pyjore)	Masë strukturore	Nr. i kullave të vrojtimit të ngritura
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS3	*Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë*
PS3.4	**Rritja e gatishmërisë dhe reagimit të bashkisë ndaj riskut sizmik**

Përshkrim

Ky projekt fokusohet në rritjen e gatishmërisë dhe reagimit të bashkisë ndaj rreziqeve sizmike. Nëpërmjet vlerësimeve të riskut, vlerësimeve të infrastrukturës dhe shërvitjeve emergjente, projekti synon të përmirësojë gatishmërinë e bashkisë për të zbutur dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ngjarjeve sizmike.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M3.4.1	Studim sizmik për ndërtesat mbi 50 vjeçare (3300 ndërtesa të ndërtuara para vitit 1960)	Masë jo-strukturore	Nr. i ndërtesave të studuara
M3.4.2	Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë (godina në pronësi të bashkisë, infrastruktura kritike në total 13 ura dhe 91 institucione shendetsore dhe arsimore)	Masë jo-strukturore	Nr. i ndërtesave të studuara
M3.4.3	Studim sizmik për ndërtesat informale 3262 ndërtime të certifikuara në territorin e bashkisë	Masë jo-strukturore	Nr. i ndërtesave të studuara
M3.4.4	Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes së strukturave bazuar në studimet e mësipërme	Masë strukturore	Projekte për zvogëlimin e riskut sizmit; Ndërhyrje për zvogëlimin e riskut sizmit
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS3	*Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë*
PS3.5	**Zbutja e impaktit te ngjarjeve me shume risqe/multirisk**

Përshkrim

Ky projekt i dedikohet zbutjes së ndikimit të ngjarjeve me shumë risqe duke inkurajuar studime dhe vlerësime gjithëpërfshirëse. Nëpërmjet vlerësimeve të integruara të riskut, planifikimit të emergjencës dhe angazhimit të komunitetit, projekti synon të rrisë gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë ndaj risqeve të njëpasnjëshme.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M3.5.1	Hartëzimi i hot-spoteve teknologjike dhe mjedisore në territorin e bashkisë Lushnje	Masë jo-strukturore	Harta me hot-spotet

M3.5.2	Vendosja e këndeve të informimit në qendrat e fshatrave për afishimin e njoftimeve për ZRF	Masë strukturore	Nr. i këndeve të informimit të vendosura
M3.5.3	Vlerësim i impaktit mjedisor i puseve të shpimit në territorin e bashkisë (Pus-shpimet Dushk-Konjat që furnizojnë Qytetin) dhe i cilësisë së ujit të pijshëm.	Masë jo-strukturore	Nr. i puseve të vlerësuara
M3.5.4	Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në territorin e bashkisë për përballimin e një epidemie të mundëshme (bashkëpunim sektori i mbrojtjes civile, shëndetësia 7 objekte qendrahs shëndetsore).	Masë jo-strukturore	Raport
M3.5.5	Vlerësim i ndotjes së tokave bujqësore dhe kalimit të elëmëntëve të ndotjes potenciale tek zinxhiri ushqimor	Masë jo-strukturore	Vlerësim
M3.5.6	Studim mbi nivelin e ndotjes së ajërit tokës dhe Ujit nga sektori teknologjik/industrial në Bashkinë Lushnje	Masë jo-strukturore	Studim
M3.5.7	Marrja e masave në bazë të studimeve për sigurimin e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja në përputhje me kompetencat e bashkisë	Masë strukturore	Projekte për adresimin e ndotjes së ajrit, tokës, ujit; Ndërhyrje për adresimin e ndotjes së ajrit, tokës, ujit
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

OS3	*Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë*
PS3.6	**Vlerësimi i impaktiti të ndryshimeve klimatike në territorin e bashkisë dhe aplikimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për mitigimin e impakteve negative**

Përshkrim

Ky projekt fokusohet në vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në territorin e bashkisë dhe implementimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë në kuadër të ZRF për të zbutur ndikimet negative. Duke kryer vlerësime dhe studime gjithëpërfshirëse të cënueshmërisë klimatike dhe risqet nga fatkeqësitë, projekti nxjerr konkluzion dhe rekomandime të vlefshme për të rritur aftësinë ripërtëritëse të bashkisë.

Masa		**Lloji i masës**	**Tregues Monitorimi**
M3.6.1	Studim mbi implementimin e zgjidhjeve të gjelbra (NbS) për reduktimin e riskut nga rrëshqitjet dhe zonat erozive	Masë jo-strukturore	Studim
M3.6.2	Studim mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në përkeqësimin e situatës së zjarreve në pyje në territorin e bashkinsë	Masë jo-strukturore	Studim

M3.6.3	Vlerësimi i ndikimit të ishujve të nxehtë urban në qytetin e Lushnjest dhe eksplorimi i përdorimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë për adresimin e tyre	Masë jo-strukturore	Studim
M3.6.4	Vlerësimi i riskut të thatësirave në kontekstin e ndryshimeve klimatike	Masë jo-strukturore	Studim
M3.6.5	Studim mbi përdorimin e bimëve akumuluese për adresimin e ploblematikës së ndotjes së tokës	Masë jo-strukturore	Studim
Kosto Totale			
Kohëzgjatja			

4.2 Plani i Veprimit dhe Boshllëku Financiar

Objektivat strategjik të këtij dokumenti, janë të përkthyera në projekte konkrete zbatimi, të cilat do të jenë baza për punën dhe ndërhyjet e investimeve gjatë viteve në vazhdim për bashkinë Lushnje në kuadër të ZRF. Në këtë strategji gjenden të listuara projektet të cilat janë konsideruar si strategjike, përsa i përket menaxhimit të riskut në të gjitha hallkat e menaxhimit: parandalimi, përgatitja, përgjigja, dhe rimëkëmbja. Projektet janë ndarë në projekte jo-strukturore, të cilat synojnë kryesisht trajnimin e komunitetit dhe stafit të bashkisë, dhe projekte strukturore, të cilat synojnë kryesisht ndërhyrje në territor me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Secili nga projektet ka të identifikuar mundësitë e financimit, bazuar në natyrën e projektit dhe kapaciteti financiar të aktorëve aktiv në sektorin në fjalë. Zbatimi i këtyre projekteve është parashikuar përgjatë një periudhe kohore prej 5-10 vjeçare. Janë prioritarizuar projektet që kanë një nevojë imediate zbatimi në kontekstin e mbrojtjes civile. Strategjia është një instrument që orienton investimet e bashkisë dhe ndihmon në thithjen e fondeve nga palë të treta.

Tabela e mëposhtme vijon duke shpejguar projektet dhe programet e objektivave strategjike si dhe financuesit e mundshëm, zbatuesit, zonën apo NjA-në ku ndodh projekti, kostot e projektit, periudhën e zbatimit, treguesit dhe Tregues Monitorimiët e zbatimit dhe ndryshimet e nevojshme ligjore ose institucionale.

Objektivi Strategjik	Projektet Strategjike	Masat		Koha	Institucionet		Kosto		Gapi Financiar	
					Bashkia	Insitucione kontribuese	Euro	USD	Euro	USD
Rritja e kapaciteteve administrative, teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF	Forcimi i kapaciteteve financiare dhe menaxheriale të bashkisë për ZRF	M.1.1.1	Trajnimi i stafit për menaxhimin financiar dhe kushtet ligjore që vijne nga niveli Kombëtar (implmentimi i plotë i transfertes se kushtëzuar nga AKMC dhe inistiativat e tjera)	2024-2030	X	AKMC, UNDP Donatorë	20000		15000	
		M1.1.2	Identifikimi dhe ngritja e një rrejti aktorësh me mundësi financimi per ndërmarrjen e inisiativave te ndryshme ne kuadër të ZRF	2024-2030	x		0		0	
		M1.1.3	Kërkimi/aplikimi për grante për financimin e projekteve te cilat adresojnë ZRF	2024-2030	x	AKMC,OSHC	0		0	
		M1.1.4	Vendosja e taksave/Tarifave Vendore te përkohshme për adresimin e masave për parandalimin e rreziqeve	2024-2030	x		0		0	
		M1.1.5	Hartimi i një plani buxhetor disa vjecar me qellim realizimin e projekteve ne kuadër të ZRF duke qene pjese integrale e dokumentit të PBA të bashkisë Lushnje	2024-2030	x		0		0	
		M1.1.6	Parashikimi në buxhet për incentivimin monetar të grupit të vullnetareve	2024-2030	x	Donatorë	20000		10000	
		M1.1.7	Parashikimi buxhetor për siguracionin e aseteve dhe burimeëve njerzore të MZSH të bashkisë	2024-2030	X		??			
	Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të stafit komunal për ZRF	M1.2.1	Shtimi i personelit te MZSH me 6 persona	2024-2026	X		0		0	
		M1.2.2	Zhvillimi i një fushate rekrutimi afatgjate për zëvendesimin e plotë të stafit të MZSH me moshë të re pune.	2024-2030	X		0		0	
		M1.2.3	Trajnimi I vazhdueshëm I stafit nga Institucionet kompetente ne lidhje me aspekte të ndryshme (mirëmbajtja e databazës GIS dhe Project cycle management në lidhje me thirrjet për projekte të emrgjencave civile).	2024-2030	X	AKMC UNDP Donatorë	30000		15000	
		M1.2.4	Rishikimi i PPV-së, strategjive dhe planeve sektoriale me fokus përshtatjen me ZRF	2024-2026	X		0		0	

	M1.2.5	Plotësimi dhe përditësimi i databazës së standartizuar të dukurive të fatkeqsive natyrore dhe vleresimit te riskut në Bashkinë Lushnje.	2024-2030	X	Bashkia,AKMC	0		0	
	M1.2.6	Formalizimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet sektorit të mbrojtjes civile në bashki dhe atij në qark	2024-2030	X	Prefektura, Këshilli I Qarkut	0		0	
Formalizimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet sektorit të mbrojtjes civile në bashki dhe atij në qark	**M1.3.1**	Hartëzimi i historikut të fatkeqsive dhe i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqsitë në sistemin GIS	2024-2030	X	Bashkia,ASIG	0		0	
	M1.3.2	Përditësimi dhe hartimi i planit të evakuimit në ndërtesat të cilat janë asete të bashkisë(objekte te administrates vendore, shkolla, çerdhe kopshte dhe objekte te nivelit parësorë shëndetsor)	2024-2026	X	Bashkia, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Shendetit,	20000		0	
	M1.3.3	Pajisja e ndërtesave publike në pronësi të bashkisë (objekte të administrates vendore, shkolla, çerdhe kopshte dhe objekte te nivelit parësorë shëndetsor) me sistemet e sigurisë për përballimin e emergjencave civile[3].	2024-2030	X	Bashkia, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Shendetit,	400000		400000	
	M1.3.4	Pajisja e stafit me mjetet e nevojshme logjistike/kancelarike (pajisje teknologjike dhe orendi) per funksionimin normal te zyrës.	2024-2026	X		30000		30000	
	M1.3.5	Blerja e 2 makinave teknologjike per emergjencat civile dhe repartin e MZSH (makine 4x4 për levizje ne terrene te vështira dhe makinë zjarrfikëse me shkallë me depozitë 3000 l ujë)[4]	2024-2026	X	Bashkia, Donatorë	80000		60000	

[3] Bashkia Lushnje ka 91 institucione te tilla nje sistem I mbrojtjes nga fakteqsite dhe sinjalistiken kushton rreth 4500 euro per nje institucion.

[4] Bashkia nw buxhet ka tw parashikuar pwr vitet 2024 dhe2025 nje fond prej 160000 mije euro per mblrjen e makinave tkenologjike 20000 do te shpenzohen te blihet nje makine e re 4x4 me depozite ujit te vogwl

		M1.3.6	Blerje e pajisjeve ndihmëse për operacionet e MZSH (këmbaleca, ganxha, shkallë hedhëse,litar përloni me kapacitet mbajtës 300 kg, kostume për mdërhyrje speciale nga 8 copë për artikull)	2024-2026	X	Donatorë	10000		5000	
		M1.3.7	Blerje pajisjesh teknologjike për ndërhyjet e specializuara të MZSH (Elektro kompresor 1 copë, Aparate frymarrje AP3 4 copë, Pajisje kundra-gaz 4 copë, Gjenerator me vaj, Hapës pneumatik, Tobo hedhëse uji profesionale, Shkumë AFFF3% 1000 litër, Hedhëse uji profesionale Fi 50 mm)	2024-2030	X	Donatorë	25000		25000	
		M1.3.8	Pilotimi dhe implementimi i sistemeve të alarmit të hershëm në linjë me SKZRF	2024-2026	X	AKMC Donatorë	??		??	
		M1.3.9	Ngritja e 1 depoje dhe Plotesimi I rezervave ushqimore dhe bazës materiale për dhënien ne ndihmës në rast emergjence[5]	2024-2030	X	AKMC UNDP Donatorë	??		??	
	Projekte ndërkufitare në nivel vendor për ZRF	**M1.4.1**	Organizimi i konferencave të donatorëve për ZRF ne nivel Qarku	2024-2026	X	Bashkia AKMC, Qarku, Prefektura	5000		0	
		M1.4.2	Kriijimi i një databaze me donatoët dhe OSHC potenciale për ofrimin e projekteve ne kuadër të ZRF dhe përditësimi i saj rast pas rasti	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet më të	**Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit mbi ZRF**	**M2.1.1**	Hartimi dhe aprovimi i moduleve/protokolleve të unifikuara të trajnimit të grupeve të interesit në bashkëpunim me AKMC	2024-2026	X	Bashkia, AKMC	0		0	
		M2.1.2	Hartimi dhe aprovimi i një kalendari për zhvillimin e seminareve me grupet e interesit	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
		M2.1.3	Rritja e bashkëpunimit me TV dhe Radio lokale të cilat mund të shërbejnë për njoftimin e popullatës në rast fatkeqësie	2024-2026	X	Bashkia, TV dhe Radio Lokale	0		0	

[5] Mbetet per tu percakuar vendi projekti ne varwsi tw godines nderkohe 5u pako ndihme te pare ushqime,batanije: çadra kushon pwrafwrsisht 400 euro= 20000

	M2.1.4	Përdorimi i rrjeteve sociale të bashkisë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për paralajmërimin në rast fatkeqësishë	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
	M2.1.5	Zhvillimi i trajnimeve me qytetarët e grup-moshave të ndryshme, me fokus ZRF, të tilla si: 1. Trajnimi i qytetarëve mbi risqe specifike në nivel Njësie Administrative (trajnimi i banorëve në rast përmbytje fshatrat Toshkëz dhe Thanasaj, trajnimi I banorëve në rast zjarri fshati Zhamë).2. Trajnimi i komunitetit mbi pastrimin e kanaleve tretësore. 3. Trajnimi i komunitetit mbi menaxhimin e ekonomive pyjore. 4. Trajnim i komunitetit për shërbimet e ekosistemit me fokus shkollat 9 vjeçare dhe të mesme. 5. - Trajnimi i kryepleqve të fshatrave për të rritur kapacitetet e tyre në lidhje me ZRF. 6. Fushata ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve tretësore nga fermerët	2024-2030	X	Bashkia, Donatorë OSHC AKMC	20000		20000	
	M2.1.6	Zhvillimi i fushatave informuese derë më derë	2024-2030	X	Bashkia	20000		20000	
Ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vurnerabël dhe grave	M2.2.1	Zhvillimi i seanca praktike trajnimi mbi ndihmën e parë, procedurat e evakuimit nga ndërtesat publike e private me fokus të veçantë tek gratë dhe grupet vulnerabël	2024-2030	X	Bashkia Kryqi I Kuq .	30000		30000	
	M2.2.2	Zhvillimi i fushatave specifike ndërgjegjësuese për ZRF të cilat targetojnë grupet vulnerabël dhe gratë	2024-2030	X	Bashkia OSHC lokale	20000		20000	
	M2.2.3	Zhvillimi i trajnimeve të evakuimit me komunitetin Rom dhe Egjiptian në zonat informale	2024-2030	X	Bashkia OSHC lokale	10000		10000	
Konsoli dimi dhe tajnimi i	M2.3.1	Ngritja e një baze digjitale të dhënash për regjistrimin e grupeve vullnetare për ZRF	2024-2026	X	Bashkia	0		0	

		M2.3.2	Trajnimi i grupeve vullnetare mbi ZRF në koordinim me modulet e përgatitura nga AKMC	2024-2030	X	Bashkia, AKMC	30000		30000	
Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë	Rritja e gatishmërisë dhe kapaciteteve parandaluese ndaj përmbytjeve	M3.1.1	Hartimi i një protokolli të standardizuar dhe monitorimi i vazhdueshëm i kanaleve kulluese dhe vaditëse në pronësi të bashkisë	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
		M3.1.2	Monitorimi periodik i kanaleve parësore (në pronësi të bashkisë), dytësore dhe tretësore duke u bazuar në një kalendar të unifikuar (sektori i mbrojtjes civile, drejtoria e bujqësisë, bordi i kullimit dhe ujitjes).	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
		M3.1.3	Monitorimi dhe Vlerësimi i gjendjes së argjinaturave të lumit Shkumbin dhe Seman evidentimi I ndërhyrjeve të reja ne skapate dhe zonave per mbushjen e argjinaturave	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
		M3.1.4	Hartimi i pashaportës së gjendjes së rezervuarëve dhe digave në pronësi të bashkisë	2024-2026	X	Bashkia	0		0	
		M3.1.5	Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të para të dyta dhe të treta në pronësi të bashkisë nga bashkia në bashkëpunim me komunitetin.[6]	2024-2030	X	Bashkia	300.000		300.000	
		M3.1.6	Studimi i thelluar i gjendjes teknike të 21 digave të rrezervuareve në Bashkinë Lushnje[7]	2024-2030	X	Bashkia	210.000		210.000	
		M3.1.7	Përmirësimi i gjendjes së digave dhe rezervuarëve në pronësi të bashkisë sipas vlerësimit	2024-2030	X	Bashkia	?		?	
		M3.1.8	Rehabilitimi i rezervuarit të Kasharajt	2024-2026	X	Bashkia,AKMC	700.000		700.000	
		M3.1.9	Hartimi i Planit të Evakuimit nga Përmbytjet në Fshatrat Thanasaj dhe Toshkëz	2024-2026	X	AKMC Donatorë	20000		20000	

[6] Bashkia ne Buxhetin e saj parashikon kete shifer pwr mirembajtjen dhe pastrimin e kanaleve
[7] Minimalisht 10000 euro persecilen Digw

	M3.1.10	Blerja e pajisjeve për pastrimin e kanaleve, një eskavator me kolonë të gjatë dhe një eskavator me goma i përshtatshëm për të lëvizur në asfalt.	2024-2026	X	Bashkia	140.000		0	
Zvogëlimi, zbutja e pasojave të mundshme negative të rrëshqitjeve	M3.2.1	Studimi gjeologjik dhe monitorim i zonave me rrezik rrëshqitje me prioritet zonat kodrinore të Hysgjokajt dhe Ballagatit.[8]	2024-2030	X	Bashkia, Donatorë	60.0000		60.000	
	M3.2.2	Marrja e masave për stabilizimin e rrëshqitjeve bazuar në studime (prioritet zona e NjA-ve Ballagat dhe Hysgjokaj)	2024-2030	X	Bashkia AKMC Donatorë	?		?	
	M3.2.3	Studim mbi largimin e Shkëmbinjve/ Gurëve me rrezik	2024-2030	X	Bashkia	5000		5000	
	M3.2.4	Marrja e masave për largimin e shkëmbinjve dhe gurrëve me rrezik bazuar në studime	2024-2030	X	Bashkia	?		?	
	M3.2.5	Implementimi i masave mbrojtëse nga rrëshqitjet në rrugën qe lidh fshatin Kasharaj me Qytetin e Lushnjes	2024-2026	X	AKMC Donatorë	1.000.000		1.000.000	
Parandalimi dhe përmirësimi i menaxhimit të riskut nga zjarri	M3.3.1	Hapja e rrugëve apo korridoreve pyjore me prioritet në zonën e Fshatit Zhamë sidhe në NjA Hysgjokaj Ballagat.[9]	2024-2030	X	Bashkia	?		?	
	M3.3.2	Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullusor	2024-2030	X	Bashkia	0		0	
	M3.3.3	Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga zjarret ndër vite me prioritet zonën e Zhamës (30 ha)[10]	2024-2030	X	Bashkia Donatorë dhe OSHC lokale	210.000		210.000	
	M3.3.4	Përgatitja e planeve për menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve per 4 ekonomitë pyjore në administrim nga Bashkia	2024-2026	X	Bashkia	25000		25000	
	M.3.3.5	Vendosja dhe furnizimi i hidranteve në qendrat e Njësive administrative NjA Ballagat, Hysgjokaj, Dushk, Karbunarë dhe Fier Shegan[11]	2024-2030	X	Bashkia Donatorët	10000		10000	

[8] Njw studim I tillw kushton minimalisht 30000 euro

[9] Hapja e rrugwve tw aksesist ne pyje kushten minimalisht 200 euro hapje sheshim dhe shtrim me çakull

[10] Njw fidan ulliri kushton 7 euro. 1 meter² 1 fidan ulliri

[11] Nje hidrant uji kushton perafersisht 500 euro

	M3.3.6	Ndërtimi i një rrjeti kullash vrojtimi në funksion të ngritjes së alarmit në rast zjarri (minimum 4, 1 përsecilen ekonomi pyjore)	2024-2030	X	Bashkia	20000		20000	
Rritja e gatishmërisë dhe reagimit të bashkisë ndaj riskut sizmik	M3.4.1	Studim sizmik për ndërtesat mbi 50 vjeçare (3300 ndërtesa të ndërtuara para vitit 1960)[12]	2024-2030+	X	Bashkia Donatorë	24.750.000		24.750.000	
	M3.4.2	Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë (godina në pronësi të bashkisë, infrastruktura kritike në total 13 ura dhe 91 institucione shendetsore dhe arsimore)[13]	2024-2030+	X	Bashkia Donatorë	700.000		700.000	
	M3.4.3	Studim sizmik për ndërtesat informale 3262 ndërtime të certifikuara në territorin e bashkisë[14]	2024-2030+	X	Bashkia Donatorë	16.300.000		16.300.000	
	M3.4.4	Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes së strukturave bazuar në studimet e mësipërme	2024-2030+	X	Bashkia Donatorë	?		?	
Zbutja e impaktit te ngjarjeve me shume risqe/multirisk	M3.5.1	Hartëzimi i hot-spoteve teknologjike dhe mjedisore në territorin e bashkisë Lushnje	2024	X	Bashkia	0		0	
	M3.5.2	Vendosja e këndeve të informimit në qendrat e fshatrave për afishimin e njoftimeve për ZRF	2024	x	Bashkia	5,000		0	
	M3.5.3	Vlerësim i impaktit mjedisor i puseve të shpimit në territorin e bashkisë (Pus-shpimet Dushk-Konjat që furnizojnë Qytetin) dhe i cilësisë së ujit të pijshëm.	2024-2026	X	Bashkia	30,000		30,000	
	M3.5.4	Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në territorin e bashkisë për përballimin e një epidemie të mundëshme (bashkëpunim sektori i mbrojtjes civile, shëndetësia 7 objekte qendrash shëndetsore).	2024-2026	X	Bashkia	20.000		20,000	
	M3.5.5	Vlerësim i ndotjes së tokave bujqësore dhe kalimit të elëmëntëve të ndotjes potenciale tek zinxhiri ushqimor	2024-2030		Bashkia	30,000		30,000	

[12] Perafersisht 7500 euro per ndertese
[13] Perafersisht 7500 per ndertese
[14] Perafersisht 5000 euro per ndertese

	M3.5.6	Studim mbi nivelin e ndotjes së ajërit tokës dhe Ujit nga sektori teknologjik/industrial në Bashkinë Lushnje								
	M3.5.7	Marrja e masave në bazë të studimeve për sigurimin e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja në përputhje me kompetencat e bashkisë								
Vlerësimi i impaktiti të ndryshimeve klimatike në territorin e bashkisë dhe aplikimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për mitigimin e impakteve negative	M3.6.1	Studim mbi implementimin e zgjidhjeve të gjelbra (NbS) për reduktimin e riskut nga rrëshqitjet dhe zonat erozive								
	M3.6.2	Studim mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në përkeqësimin e situatës së zjarreve në pyje në territorin e bashkinsë								
	M3.6.3	Vlerësimi i ndikimit të ishujve të nxehtë urban në qytetin e Lushnjes dhe eksplorimi i përdorimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë për adresimin e tyre								
	M3.6.4	Vlerësimi i riskut të thatësirave në kontekstin e ndryshimeve klimatike								
	M3.6.5	Studim mbi përdorimin e biméve akumuluese për adresimin e ploblematikës së ndotjes së tokës								

4.3 Zbatimi i Strategjisë

Pas miratimit të Strategjisë në Këshillin Bashkiak, sektori i mbrojtjes civile në bashki ngarkohet me zbatimin e strategjisë. Dokumenti i strategjisë është hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe përtej angazhimit të sektorit të mbrojtjes civile është e nevojshme që të koordinohet me të gjithë sektorët e tjerë sipas angazhimit të tyre në Komisionin e Mbrojtjes civile dhe grupin e punës për hartimin e strategjisë.
Shumë prej projekteve të cilat janë pjesë të planit të veprimit dhe plotësojnë kuadrin strategjik kërkojnë përfshirjen e sektorëve të ndryshëm për zbatimin e tyre. Kjo përfshirje nuk nënkupton thjesht angazhimin e kapaciteteve teknike, por edhe të atyre financiara. Pra, është e rëndësishme që në momentin që hartohet Plani Buxhetor Afat-mesëm dhe më pas Buxheti Vjetor, të ketë një koordinim të mirë të sektorëve në mënyrë që të përdoren të gjitha burimet dhe kapacitetet teknike e financiare.
Është e qartë që bashkia me kapacitetet e saja financiara nuk mund të mbulojë të gjitha kostot e zbatimit të strategjisë. Për këtë arsye është e nevojshme që sektori i mbrojtjes civile të punojë ngushtësisht me njësinë e projekteve në bashki në mënyrë që të jenë të përgatitur për t'Ju përgjigjur thirrjeve të ndryshme për projekt propozime në fushën e mbrojtjes civile. Në seksionin 2.3 të kësaj strategjie janë paraqitur disa nga burimet kryesore të financimit ku bashkia mund të aplikojë për projekte.
Po ashtu, bashkia duhet të synojë që të rrisë bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, institucione kërkimore, universitete etj në mënyrë që të krijojë sinergji të aktiviteteve të cilat ndodhin në territorin e saj në kuadër të mbrojtjes civile. Krijimi i partneriteteve me institucione të tilla shërben jo vetëm për nisma të përbashkëta dhe koordinimin e aktorëve në territor, por edhe për të rritur mundësinë për aplikimin për projekte të ndryshme.
Së fundmi, pas miratimit të kësaj strategjie, lind nevoja që të studiohen në detaj strategji të tjera vendore dhe të përshtaten sipas përcaktimeve të kësaj strategjie. Veçanërisht është e nevojshme që të shihet Plani i Përgjithshëm Vendor në mënyrë që të përshtatet me nevojat e riskut të fatkeqësive dhe me parashikimet e Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut.

4.4 Monitorimi

Monitorimi i Strategjisë duhet të kryhet në dy nivele. Fillimisht është e rëndësishme që të kuptohet sa dhe si po zbatohet strategjia. Për këtë qëllim, për secilin prej projekteve strategjike janë përcaktuar një sërë treguesish për monitorimin e zbatimit të tyre. Këto tregues duhet të maten në bazë vjetore dhe ato i mundësojnë bashkisë që të shikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e strategjisë vendore. Këto tregues duhet të mblidhen në mënyrë vjetore dhe të raportohen si në nivel bashkie tek Komisioni Vendor i Mbrojtjes Civile, tek titullarët e Institucionet dhe në Këshillin Bashkiak. Përtej kësaj, një raport monitorimi i zbatimit të Strategjisë mund të shpërndahet edhe tek Prefekti i Qarkut Fier si dhe tek AKMC.
Përtej monitorimit të zbatimit të Strategjisë, Bashkia duhet të monitorojë dhe impaktin që ka zbatimi i strategjisë në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Ky monitorim mund të kryhet në bazë të treguesve të saktësuar më poshtë. Gjithësesi, këto tregues janë indikativ dhe varësisht të dhënave, bashkia mund të shtojë treguesit për të kryer një

panoramikë sa më të plotë të nivelit të riskut. Treguesit e mëposhtëm duhet të maten të paktën 1 herë në vit dhe të raportohen në instancat përkatëse si më sipër.
Është shumë e rëndësishme që procesi i monitorimit të kryhet në kohë dhe në mënyrë sistematike. Monitorimi i mirë ndihmon më pas në momentin që bashkia Lushnje do të duhet të rishikojë vlerësimin e riskut (çdo 3-vjet) dhe vetë dokumentin e strategjisë (çdo 5-vjet). Pra, këto tregues, përtej rritjes së transparancës së bashkisë, ndihmojnë në procesin e rishikimit të instrumentave të mbrojtjes civile.

- Zvogëlimi i humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqsitë;
- Zvogëlimi i numrit të personave të prekur nga fatkeqsitë;
- Zvogëlimi i numirt të banesave të prekura nga fatkeqsitë;
- Zvogëlimi i numrit të ndërmarjeve ekonomike të prekura nga fatkeqsitë;
- Zvogëlimi i numrit objekteve publike me rëndësi të veçantë të prekura nga fatkeqsitë;
- Zvogëlimi i sipërfaqeve të infrastrukturave kritike të prekura nga fatkeqsitë;
- Zgogëlimi i siperfaqeve natyrore të prekura nga fatkeqsitë;
- Zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore të prekura nga fatëkeqsitë;
- % e zbatimit të masave te Strategjisë së ZRF në Bashkinë Lushnje në investime;
- % e zbatimit të masave te Strategjisë së ZRF në Bashkinë Lushnje në numër projektesh të zbatuara;
- Mbështetje në ngritjen e kapaciteve për ZRF numër pajisjesh dhe lloj pajisjesh;
- Mbështetje ne ngritjen e kapaciteteve për ZRF numer trajnimesh dhe persona të trajnuar kunderejt stafit të bashkisë;
- Investime të ardhuara nga donataorë apo projekte ndërkombëtare në në (ALL);
- Numër projektesh nga donatorë apo projekte ndërkombëtare;
- Numër marreveshjesh bilaterale me institucione të tjera në nivel Vendor, Kombëtare dhe Ndërkombëtare në lidhje me ZRF;
- % e popullsisë së mbuluar me trajnime në rast emergjencash;
- % e popullsise së mbuluar me sisteme të hershme te alarmit nga fatkeqsitë.

5. Referencat

6. Anekset

Aneks 1 – Projekte të ekstraktuara nga plane dhe strategji kombëtare dhe sektoriale

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030
Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë me shumë risqe
Projekti strategjik 4: Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Bashkinë X

1. Sigurimi i furnizimit me mjete, automjete dhe pajisje për sektorin e MC dhe Shërbimin e MZSH-së;
2. Rritja e formimit profesional të stafit të MZSH-së

Projekti strategjik 7: Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)

1. Zbatimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë
2. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave

Projekti strategjik 8: Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut

1. Kryerja e një studimi për përfshirjen në programet shkollore të njohurive të Mbrojtjes Civile,
2. Zbatimi i planit të veprimit për përfshirjen në programet shkollore të njohurive të Mbrojtjes Civile.
3. Zhvillimi i një programi ndërgjegjësimi publik për ZRF dhe të planit të veprimit
4. Zbatimi i planit të veprimit të ndërgjegjësimit publik për ZRF

Projekti strategjik 9: Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile

1. Zhvillimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile bazuar, ndër të tjera, në Planin e ri Kombëtar të Emergjencave Civile
2. Mbështetja e konsultimeve ndërinstitucionale dhe miratimi i programit të trajnimit
3. Implementimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile

Projekti strategjik 10: Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje (JICA) *(tregon aktivitete te projektit me qeverine japoneze; aktivitete te mundshme tek projektet strategjike per riskun e zjarreve)*
Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje: "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";
Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve"
Projekti strategjik 12: Forcimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm

1. Blerja dronëve të nivelit mesatar;
2. Trajnimi i nevojshëm për përdorimin e dronëve
3. Identifikimi i mangësive të tjera duke pasur parasysh investimet në vijim ose Zhvillimi i Listës Kontrolluese të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm
4. Në afat të shkurtër: blerja e një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katëarn, Nokia
5. Blerja e Licencave përkatëse për Softëare, Instalim, Integrim
6. Parashikimi i kostove të mirëmbajtjes dhe llogaritja e kostove përkatëse për tarifat vjetore për kompanitë që blejnë licenca.

Projekti strategjik 14: Forcimi i gatishmërisë financiare të vendit përmes miratimit të një Programi Kombëtar të Financimit të Riskut nga Fatkeqësitë

1. Transparenca e shpenzimeve pas fatkeqësisë dhe ofrimi i likuiditetit të shpejtë
2. Rregullimi i procesit të financimit pas fatkeqësisë

3. Rritja e disponueshmërisë së fondeve për qeveritë vendore
4. Qasje në shërbimet financiare pas fatkeqësisë nga familjet, fermerët dhe bizneset dhe të varfrit
5. Sigurimi nga tërmetet për familjet
6. Mbrojtja sociale e përshtatur
7. Menaxhimi i risqeve të lidhura me fatkeqësitë e sektorit financiar dhe privat dhe mobilizimi i financave për forcimin e aftësisë ripërtëritëse (investime të gjelbra dhe të qëndrueshme)

Projekti strategjik 17: Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave
1. Punime të mundshme për qendrat e operacionale dhe qendrave të trajnimit
2. Zhvillimi i procedurave standarde operacionale
3. Trajnime

Projekti strategjik 22: Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.
1. Ndërgjegjësimi dhe ngritja e organizatave vullnetare;
2. Forcimi i teknologjisë për monitorimin operacional;
3. Sistemi për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësite natyrore;
4. Mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.

Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Projekti strategjik 1: Rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytjet e lumenjve, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja
1. Kryerja e studimeve të fizibilitetit për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet
2. Rehabilitimi/Rikonstruksioni dhe ndërtimi i argjinaturave kundër përmbytjeve dhe strukturave mbrojtëse nga erozioni
3. Rritja e kapaciteteve operacionale, mirëmbajtjes dhe monitoruese të sigurisë së argjinaturave në strukturat përkatëse të MBZHR dhe Bashkive

Projekti strategjik 2: Rritja e sigurisë së digave të rezervuarëve të ujitjes, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të digave ekzistuese
1. Kryerja e studimit të fizibilitetit të digave
2. Kryerja e projekteve të zbatimit për grupin prioritar të digave
3. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në diga
4. Rehabilitimi/Rikonstruksioni i digave ekzistuese sipas prioritetit të përcaktuar
5. Ngritja/Konsolidimi dhe trajnimi i Grupeve të Sigurisë së Digave për çdo bashki.

Projekti strategjik 3: Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm
1. Analiza e hidrologjike e prurjeve në lumenj
2. Ndërtimi i një modeli hidrologjik për parashikimin e përmbytjeve.

Projekti strategjik 9: Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet

1. Studimet e fizibilitetit dhe projektimi i mbrojtjes strukturore dhe jostrukturore nga përmbytjet, me prioritet zgjidhjet e bazuara në natyrë
2. Punime ndërtimi/rehabilitimi
3. Planifikimi i mirëmbajtjes dhe prokurimi i pajisjeve të nevojshme
4. Trajnime

Rrëshqitjet e tokës

1. Projekti strategjik 2 : Identifikimi i rrëshqitjeve të tokës në të gjithë territorin e X bashki dhe krijimi i një inventari për rrëshqitjet, i cili përmban të gjitha të dhënat e tyre.
2. Përgatitja e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore të rrezikuara historikisht nga rrëshqitjet (zonimi i rrëshqitjeve);
3. Përgatitja e një plani emergjence në rast të përballjes me një fatkeqësi natyrore/rrëshqitje toke

Zjarret në Pyje

Projekti strategjik 1: Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet

1. Ngritja, Pajisja, Trajnimi i Moduleve të Mbrojtjes Civile të Shuarjes së zjarrit nga toka

Projekti strategjik 4: Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit

2. Studimi i zonave pyjore me risk të lartë nga zjarri në Shqipëri.
3. Studimi i nevojave të kapaciteteve njerëzore në lidhje me sistemin e vrojtim - sinjalizimit në nivel kombëtar.
4. Studimi i kostove dhe burimeve financiare të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të vrojtim-sinjalizimit.

Projekti strategjik 7: Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

1. Vlerësimi i vendndodhjeve, funksionalitetit dhe sigurisë së stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki.
2. Krijimi i Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së

Tërmetet

Projekti strategjik 7: Ngritja e kapaciteteve për zbutjen e riskut sizmik në vendet e trashëgimisë kulturore:

1. Trajnimit të ekspertëve në fushën e restaurimit dhe transmetimit të njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim
2. Përpilimit të manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit;
3. Përmirësimit të normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit.
4. Rritja e numrit të ekspertëve të fushës në administratën vendore;
5. Kryerja e vlerësimeve sizmike të digave, shkollave, spitaleve dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë funksione kolektive
6. Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të monitorimit sizmik
7. Konsolidimi i stafit të Mbrojtjes Civile në administratën lokale;

8. Përfshirja e informacionit bazë për tërmetet në kurrikulat shkollore.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit

Titulli i veprimit prioritar nr.7: Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet me aftësi ripërtëritëse kundrejt ndryshimeve të klimës

1. Reformim të strukturave për të bërë një përdorim më efikas të ujit, një menaxhim më intensiv, si edhe procedura financiare më të besueshme.
2. Sa i takon kullimit, është shumë e rëndësishme të gjenden mënyra dhe teknologji të reja për përmirësimin e rrjeteve të kullimit.
3. mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve ekzistuese të ujitjes si edhe hapjen e kanaleve të reja.
4. Administrimi më i mirë i lumenjve dhe sigurie digave.
5. Kapaciteti i digës ka rënë për shkak të mbushjes së vëllimit me sediment, dhe kështu është rritur edhe rrezikui përmbytjeve.
6. Për përmbytjet e shkaktuara nga lumenjtë është e rëndësishme të bëhet një administrim më i mirë i lumenjve, përfshirë modelimin hidraulik, sipas qasjeve dhe sistemeve kompjuterike më të reja.
7. Përmirësimi i infrastrukturës dhe mirëmbajtja e saj për t'u bërë ballë ndryshimeve në regjimin e reshjeve dhe sedimentit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike (kullimi, siguria e digave dhe përmbytjet).
8. Zhvillim i një plani për pakësimin e erozionit nëpërmjet bimëve
9. Forcimi strukturave të monitorimit të sigurisë së digave
10. Rehabilitimi dhe rritja e sigurisë së digave

Titulli i veprimit prioritar nr.14 Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore

1. Përgatitje e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për përmbytjet dhe përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave në nivel qarku
2. Ndërgjegjësim /dukshmëri / komunikim: të përmirësohet ndërgjegjësimi publik për përmbytjet nëpërmjet informimit për rrezikun, sistemeve të sinjalizimit të hershëm dhe planit që duhen ndjekur në rast fatkeqësie

Aneks 2 - Minutat e takimit hapës për projektitn "Hartimi i Strategjive Vendore për Zvoglimin e Riskut nga Fatkeqsitë dhe Planet e Veprimit për 6 Bashkitë e Qarkut Fier"

Mbështetur nga: Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL UNDP
Zhvilluar pranë Prefektit të Fierit, Fier, Shqipëri
18.12.2023

Pjesëmarrës në takim:

- Prefekti i Fierit – Z. Lefter Shehaj
- Drejtori i përgjithsëm i AKMC-së – Z. Haki Cako
- Oficere e programit, SIDA – Znj. Linda Gjermani
- Përfaqësuese e UNDP-së në Shqipëri – Znj. Monica Merino
- Koordinator kombëtar i projektit RESEAL – Z. Doreid Potoshati

- Kryetarët e bashkive të qarkut të Fierit
  - Bashkia Fier – Z. Armando Subashi
  - Bashkia Lushnje – Znj. Eriselda Sefa
  - Bashkia Roskovec – Znj. Majlinda Bufi
  - Bashkia Divjakë – Z. Josif Gorrea
  - Bashkia Patos – Z. Fation Duro
  - Bashkia Mallakastër – Z. Qerim Ismailaj
- Ekipi i punës së firmës konsulente MetroPolis dhe Co-PLAN

Takimi nisi me fjalët hapëse të prefektit të Fierit, si një ndër aktorët kryesorë në projekt por edhe si moderator i takimit hapës. Gjatë fjalëve hapëse, u theksua përparimi i Shqipërisë në sektorin e mbrojtjes civile dhe në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në 2 vjeçarin e fundit nëpërmjet përparimeve ligjore, instrumentave në dispozicion, hartimit të dokumentit të vlerësimit të riskut dhe strategjisë në nivel kombëtarë nga aktorët ndërkombëtarë dhe kombëtarë prezent në takim (Sida, UNDP, AKMC). Gjatë këtij procesi u evidentua qarku Fier dhe bashkitë e saj për të pilotuar hartimin e këtyre dokumenteve edhe në nivel rajonal dhe vendor, duke qënë se është një territor ku gjejmë të 6-ta risqet e evidentuara edhe në nivel kombëtar (risku nga zjarret, përmbytjet, biologjik, sizmik, tekonologjik/industrial, rrëshqitjet). Në këtë kontekst, faza e parë e projektit, hartimi i dokumenteve të riskut për 6-të bashkitë e qarkut të Fierit, është mbyllur dhe janë miratuar pranë këshillave bashkiak përkatës. Me këtë takim fillon procesi i hartimit të strategjive për zvogëlimin e riskut në këto bashki me synim ndërmarrjen e masave konkrete për parandalimin, paralajmërimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë.
Më pas takimi vijoi me një prezantim mbi procesin që do të zhvillohet për hartimin e strategjive në këto 6-të bashki nga udhëheqësi i ekipit të punës së firmës konsulente MetroPolis & Co-PLAN, Z. Ledio Allkja. Në këtë prezantim u parashtrua përmbatja e dokumentit dhe procesi i bashkëpunimit me bashkitë.
Pas prezantimit u zhvillua një diskutim i hapur me kryetarët e bashkive prezentë në sallë, të cilët theksuan rëndësinë e projektit dhe gadishmërinë e tyre maksimale për të bashkëpunuar me ekipin e punës në procesin e hartimit të strategjisë. Kryetarja e bashkisë Roskovec, Znj. Majlinda Bufi, sugjeroi që takimet e tjera të përbashkëta me të gjithë aktorët e interest në projekt të zhvillohen në bashki të ndryshme. Kryetari i bashkisë Fier, Z. Armando Subashi, u ndal tek risku i përmbytjeve specifikisht të shkaktuara nga dalja e Lumit Vjosë nga shtrati si pasojë e urës së autostradës, konstatim i mbështetur në studime. Adresimi i këtij problemi evidentohet si një projekt strategjik nga bashkia e Fierit në kuadër të zvogëlimit të riskut nga përmbytjet, dhe shpreh gadishmërinë e bashkisë për të kontribuar në bashkëpunim me donatorë të tjerë. Gjithashtu ngreh edhe problematikën e digave si një potencial i lartë risku përshkak të degradimit të infrastrukturës. Spëcifikisht për këtë problematik, drejtori i përgjithshëm i AKMC-së shprehet se është krijuar një fond i dedikuar për vlerësimin e gjendjes së digave dhe kryerjen e investimeve përkatëse.
Pas mbylljes së diskutimit të hapur përbyllet edhe takimi i parë i kësaj faze të projektit.







Aneks-3 Takimi I-rë koordinues me grupin e Punës me Bashkinë Lushnje

Titulli i aktivitetit:	Takimi I-rë koordinues me grupin e Punës me Bashkinë Lushnje
Data e zhvillimit të aktivitetit:	20/12/2023
Vendi:	Salla e keshillit Bashkiak Bashkia Lushnje
Objektivi kryesor:	Objektivi kryesor i këtij takimi ishte vendosja e kontakteve me grupet e punës dhe shpjegimi i metodologjisë së punës për projektin e hartimit të Strategjisë Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë Bashkia Lushnje.
Përshkrim i aktivitetit: (maksimumi 1 faqe)	Fjalën hapëse të këtij takimi fillestar në Bashkinë Lushnje e mbajti nënkryetari i bashkisë i cili nënvizoi edhe nevojën për këtë dokument të rëndësishmë i cili do ta ndihmojë bashkinë Lushnje të përballet me sfidat e mbrojtjes civile dhe rrezikun nga fatkeqsitë në terrtirotin e saj. Nënkryetari shprehu që institucioni i Bashkisë Lushnje dhe grupi i punës do të jenë në gadishmëri të plotë për hartimin e këtij dokumenti. Përfaqësuesi i Projektit RESEAL UNDP Doreid Petoshati parashtroi punën e mëparshmë që është zhvilluar në kuadër të projektit RESEAL gjithashtu theksoi rëndësinë që mbart hartimi i strategjisë për menaxhimin e fatkeqësivë në terretoriet e bashkive si dhe

	prezantoi konsorciumin CoPLAN-Metropolis i cili do të asistojë hartimin e këtyre strategjive të cilët kanë një eksperience të gjërë në këtë fushë. Udhëheqësi i Konsorciumit CoPLAN dhe Metropolis DR. Ledio Allkja shpjegoi metodologjinë e procesin nëpër të cilin do të kalojë projekti. Në muajt janar-shkurt pas mbylljes së analizimit të riskut grupi i punës do të njihet me vizionin, objektivat dhe listën e projekteve paraprake për bashkinë dhe kjo do të shoqërohet me një fazë konsultimesh me grupet e interesit sidhe me NjA-t e më pas edhe me komunitetin ku mendimet e të gjithëve do të pasqyrohen në strategjinë përfundimtare. Këto projekte do të jenë nevojat reale të parashtruara nga bashkia. Në pjesën e dytë takimi u fokusua në marrjen e disa të dhënave të përgjithshme në raport me shërbimin e mbrojtjes civile sidhe kapacitetet institucionale që ka bashkia në këtë drejtim. Sektori i mbrojtjes civile në Bashkinë Lushnje përbëhet nga 3 persona në ogranikën e punës, 1 Përgjegjës me profesion ushtarak, dhe një specialist me profesion ekonomist sidhe një vakance. Ky sektor është pjesë e drejtorisë së Shërbimeve publike ku rast pas rasti angazhohen edhe me punë të tjera të sektorit të shërbimeve. Në Lushnje nuk ka një qendër operacionale për emergjencat civile por ka ambjente zyrash apo pajisjesh të zyrës që i dedikohen sektorit, gjithashtu kjo zyrë nuk ka mjete të dedikuara për emergjencat por në rast emergjencash përdore mjetet e bashkisë të cilat zakonisht i përdor drejtoria e sherbimeve. Stafi i dedikuar për emergjencat ka qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme të zhvilluara kryesisht nga AKMC. Gjithsesi ndjehet nevoja e mëtejshme e trajnimeve për zbërthimin e ligjit të ri sidhe për mbajtjen e të dhënave në sitsemin GIS. Në bashki ka plan të emergjencave civile si dhe plane sezonale për rreziqet ku plani i rrezikut nga zjarri zhvillohet për periudhën pranverë-verë ndërkohë plani për përmbytjet në periudhën vjeshtë-dimër. Këto dy plane i shpërndahen NjA-ve të bashkisë. Sa i përket financimit Bashkia Lushnje ka përfituar projekte të FSHZH dhe nga AKMC si dhe kemi parashikuar në PBA dhe mjete për të zgjeruar logjistikën kryesisht për MZSH. Bashkia në bashkëpunim me donatorë ka ndërtuar rreth 12 banesa për termetin. Sa i përket mbajtjes së të dhënave për fatkeqsitë bashkia ka një inventar të fatkeqsive sidhe dorzon formatin e stadartizuar të inventarit të fatkeqsive tek AKMC daten 25 të çdo muaji. Ky format është në programin excel. Në rast rreziku apo fatkeqsie bashkia ka një grup vullnetarësh të cilët janë pjesë e grupi me urdhër të kryetares por nuk kanë stimulime financiare apo nuk janë të trajnuar për veprimtari të tilla. Bashkëpunimi ndërmjet drejtorive është i frytshëm por nuk është në nivelin e duhur, kryesisht ky bashkëpunim është me drejtoritë e Planifikimit, Sherbimeve, apo drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

	Në rast fatkeqsishë kemi një protokoll të caktuar ku lajmërohen Administratoret e NJA dhe kryepleqtë në rast kur lajmërimi bëhet nga AKMC apo IGJEO. Ka raste kur Kryepleqtë vënë në dijeni Administratorin dhe Drjetorinë në bashki dhe me pas vihet në lëvizje MZSH. Kanalet e lajmërit kryesisht janë me telefon ku kemi një grup "ëhatsapp" sidhe me afishime rrjete sociale apo TV.
Nr. i pjesëmarrësve	**Pjesëmarrës:** Përfaqësues nga Bashkia 26 Përfaqësues nga organizata COPLAN-Metropolis 4 Përfaqsues nga AKMC 1 Përfaqsues nga RESEAL 2 Në të gjitha rastet në minuta duhet specifikuar numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë. *Shembull*: në takim/trajnim ishin prezent xx Femra xx Meshkuj. Femra pjesëmarrëse – 8 (numër) Meshkuj pjesëmarrës –25 (numër)







Aneks 3- Takim me grupin e punës në Bashkinë Lushnje

Pojekti: Hartimi i Strategjive Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planeve të Veprimit për 6-të Bashkitë e Qarkut Fier

Titulli i aktivitetit:	Takim me grupin e punës në Bashkinë Lushnje
Data e zhvillimit të aktivitetit:	07/02/2024
Vendi:	Bashkia Lushnje
Objektivi kryesor:	Takim me grupin e punës, diskutim mbi zhvillimin e vizionit dhe objektivave të Strategjisë Vendore si dhe diskutimi për projekte potenciale për parandalimin dhe adresimin e riskut nga fatkeqësitë.
Përshkrim i aktivitetit: (maksimumi 1 faqe)	Takimi u zhvillua në ambientet e Bashkisë Lushnje dhe në këtë takim ishin prezent përfaqësues nga Bashkia Lushnje,AKMC, UNDP, Prefektura Fier, grupi i punës dhe eksperti i ndërkombëtar nga MetroPOLIS/Co-PLAN.. Takimi nisi me fjalën hapëse të Nën-kryetarit të bashkisë Lushnje, i cili shpreh rëndësinë e zhvillimit e strategjisë për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive dhe shprehet falenderues ndaj grupit të punës së bashkisë Lushnje si dhe grupit të punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN, AKMC dhe UNDP. Më pas fjalën e mori eksperit i UNDP, i cili shprehu rëndësinë e këtij projekti dhe rëndësinë e gjithëpërfshirjes së të gjitha palëve. Z. Maksimiljan Dhima vuri një theks të veçantë mbi rëndësinë që ka përfshirja e grupeve vulnerabël dhe menaxhimi i saktë i fondeve. Në vijim fjalën e mori eksperti i grupit të punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN z. Ledio Allkja i cili bëri një përshkrim të shkurtër të axhendës së ditës dhe ecurinë e punës që nga takimi i kaluar. Eksperti i ndërkombëtar, z. Panteleon Skayannis, bëri një prezantim të Koncepteve themelore të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore duke u vendosur theksin tek rëndësinë tek masat për parandalimin dhe më pas menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë. Më pas, z.Allkja bëri një prezantim të shkurtër të projektit si dhe profilit të bashkisë Lushnje bazuar tek dokumenti i vlerësimit të riskut për këtë bashki. Në vijim u prezantuan, vizioni, objektivat për hartimin e Strategjisë vendore ZRF si dhe një listë me projekte potenciale për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkqësitë. Diksutimi për pikat e forta dhe të dobta të bashkisë u zhvillua në formën e një diskutimi të hapur i cili u moderua nga Z. Allkja.

	Gjatë diskutimit përfaqësuesit e grupit të punës ngritën problematikat si mëposhtë: Nga sektori i zjarrëfikëses u ngritën problematika si mungesa e rrugëve pyjore, mjeteve si autoshkallë apo automjete si dhe bazë materiale për punonjësit si uniforma apo këpucë. Përfaqësuesit sugjerojnë pika apo kulla vrojtimi në hapësira pyjore, në mënyrë që risku nga zjarret të minimizohet. Sa i përket problematikës me rrëshqitjet, bashkia Lushnje haset shpesh me këtë fenomen. Në afërsi të fshatit Savër ka patur raste të rrëshitjes pranë autostradës. Përfaqësues të NjA Hysëgjokaj shprehen se nevojiten mure mbajtëse nga rrëshqitjet, kjo për shkak të incidencës së fenomenit. Gjithashtu dhe pranë rezervuarit të Kasharajt toka është e paqëndrueshme dhe rast pas rasti bëhen ndërhyrje ne infrastruktutë, si dhe në kodrina. Sa i përket përmbytjeve, problematike shfaqet diga e Kasharaj, e cila është e nevojshme të bëhet një vlerësim mbi gjendjen dhe potencialisht të rehablitohet. Gjithashtu është e nevojshme dhe mirëmbajtja e argjinaturës së lumit Shkumbin, për të evituar daljen nga shtrati të lumit. Edhe argjinatura e lumit Seman në NjA Bubullimë dhe Allkaj ka nevojë për mirëmbajtje. Në afërsi të fshatit Imsht ndodhen 2 pika kritike, ku argjinatura është dëmtuar rëndë dhe ka nevojë për rehabilitim. Sa i përket sektorit të bujqësisë, gjatë sezonit të thatësirave të tejzgjatura, vaditja është problematike në tokat bujqësore. Në sezonin e verës rezervuarë si ai i Thanës nuk janë në kapacitetin e tyre maksimal. Bashkia në territorin e saj ka në total 15 rezervuarë, 14 prej tyre të pajisur me pasaportë teknike. Megjithatë, është i nevojshëm një vlerësim mbi gjendjen e digave. Në disa raste, bashkia është hasur dhe me përmbytje të tokave bujqësore, siç ishte rasti në Zharrëz. Sa i përket sigurisë nga risku sizmik, është i nevojshëm vlerësimi i institucioneve publike. Gjithashtu, është nevoja për vendosje të shkallëve të emergjencës në disa institucione, si dhe herë pas here, simulime mbi mënyrën se si duhet bërë evakuimi. Në të gjithë sektorët shprehet nevoja për shtimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe trajnime në fusha të veçanta për punnjësit. Në nivel bashkiak, shprehet interes për formimin dhe trajnimin e grupeve vullnetare, prandaj duhet një metodologji e unifikuar për trajnimin e vullnetarëve, në bashkëpunim me sektorin e zjarrëfikësve apo të mbrojtjes civile.

Aneks 4. Takimi me grupin e punes në Bashkinë Lushnje


Pojekti: Hartimi i Strategjive Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planeve të Veprimit për 6-të Bashkitë e Qarkut Fier

Titulli i aktivitetit:	**Pjesëmarrës:** Takim me grupin e punës në Bashkinë Lushnje Nëse ka përfaqësues të organizatave të ndryshme apo institucione publike të cfarëdolloji duhet të përmenden specifikisht.
Data e zhvillimit të aktivitetit:	25/03/2024
Vendi:	Bashkia Lushnje
Nr. i pjesëmarrësve	Përfaqësues nga Bashkia: 28 Përfaqësues nga Prefektura Fier 1 Përfaqësues nga organizata/institucione 5 MetroPOLIS/Co-PLAN; 1 UNDP 1 AKMC Të pranishëm total 36 Femra pjesëmarrëse – 9 Meshkuj pjesëmarrës – 27
Objektivi kryesor:	Takim me grupin e punës, prezantim i projekteve strategjike dhe diskutim mbi detajimin dhe përmiresimin e projekteve potenciale për parandalimin dhe adresimin e riskut nga fatkeqësitë.
	Takimi u zhvillua në ambientet e Bashkisë Lushnje dhe në këtë takim ishin prezent përfaqësues nga Bashkia Lushnje dhe grupi i punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN.
Përshkrim i aktivitetit: (maksimumi 1 faqe)	Takimet u zhvilluan individualisht me secilin sektor, në mënyrë që të kishte një qasje dhe diskutim më konkret në lidhje me secilin sektor pjesë të grupit të punës. Më konkretisht, sektorët me të cilët u diskutua në Bashkinë e Lushnjes ishin sektori pyje, bujqësi dhe mjedis, sektori i urbanistikës, sektori i financës, përfaqësues nga MZSH dhe bordi i kullimit të bashkisë. Grupit të punës ju bë një prezantim i projekteve potenciale të menduara nga MetroPOLIS/Co-PLAN, si dhe ju kërkua të bënin komentet e tyre mbi relevancën dhe konkretizimin e këtyre projekteve. Sektori i emergjncave në bashki u shpreh se një ndër problemet kryesore që haset bashkia Lushnje janë rrëshqitjet e dherave. Për këto, atyre u nevojiten studime të mirëfillta gjeologjike, në mënyrë që të planifikojnë ndërhyrjet në territor. Sektori i mjedisit problematik kryesore përmendi zonën industriale, e cila sjell një sërë problematikash, që nga ndotja, e deri tek rrezikimi i jetës së popullsisë. Drejtoria e pyjeve nevojë më emergjente kanë hapjen e rrugëve pyjore, për akses në zona të largëta në rast zjarresh. Sektori i MZSH shprehet se ka mungesë të stafit si dhe të mjeteve logjistike. Gjithashtu, ata shprehin nevojën e vendosjes së hidrantëve në qëndrat e njësive administrative. Ndërkaq, sektori i ujitjes dhe kullimit projektin më prioritar mendon vlerësimin e kanaleve të larta dhe riparimin e shkarkuesit katastrofik dhe ujëlëshuesit. Në territorin e bashkisë ka probleme tek rezervuarët në procesin e mbushjes si dhe ka problematikë në aksesin me eskavatorë tek kanalet. Gjithashtu, ata shprehen se për shkak të thatësirës ka mungesë të ujitjes. Sektori i fundit që u vizitua ishte sektori i financës, ku u shprehën se fondi i kushtëzuar për EC nuk disbursohet i gjithi, dhe se pjesa më e

	madhe e tij shkon për dëmshpërblime. Ata sygjerojnë trajnime per alokimin e 4% si dhe mbështesin idetë e grupit të punës sa i përket sigurimit të aseteve të bashkisë.
Nr. i pjesëmarrësve	**Pjesëmarrës:** Nëse ka përfaqësues të organizatave të ndryshme apo institucione publike të çfarëdolloji duhet të përmenden specifikisht. Përfaqësues nga Bashkia: 7 Përfaqësues nga organizata/institucione 3 MetroPOLIS/Co-PLAN, Te pranishëm total - 10 Femra pjesëmarrëse – 5 Meshkuj pjesëmarrës – 5







Aneks 5- Kuadri Ligjor

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen drejtpërsëdrejti me mbrojtjen civile:

- VKM 807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile"
- Ligji Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"
- VKM nr. 747, Datë 20.11.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile".
- VKM nr. 431, Datë 15.07.2021, "Për përbërjen dhe detyrat e njësive organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile në ministritë e linjës".
- VKM nr. 1162, Datë 24.12.2020, "Për përcaktimin E procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi".
- VKM nr. 923, Datë 25.11.2020, "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile".
- VKM nr. 1186, datë 24.12.2020, "Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit".
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm nr. 81, datë 6.3.2020, – "Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri".
- VKM nr. 168, datë 24.3.2023, "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror", (Fletore Zyrtare nr.51/2023)".
- VKM nr. 94, datë 22.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe planit të veprimit", (Fletore Zyrtare nr.31, 24.02.2023).
- VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 "për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive"

- VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"
- VKM Nr. 414 datë 8.7.2021 'Për Miratimin e Procedurave dhe Kritereve të Ndarjes dhe të Përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile'
- VKM Nr. 290 datë 17.5.2023 'Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 414, Datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Procedurave dhe Kritereve të Ndarjes dhe të Përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile'
- VKM Nr. 2060 datë 27.4.2023 'Për Miratimin e Projekteve Fituese të Financuara nga Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, si dhe të Autoritetit Kontraktor për Zbatimin e Projekteve, Sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore'
- Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore" miratuar me Ligjin Nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".
- Vendimi nr. 158, datë 17.03.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore".
- Vendimi nr. 775, datë 15.12.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive".
- Vendimi nr. 667, datë 10.11.2021 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e te përballimit të fatkeqësive"
- Vendimi nr. 345, datë 26.05.2022 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë".
-

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me ndryshimet klimatike:
- Ligj nr. 75/2016, Datë 14.07.2016, Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit në kuadër të konventës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimaterike;
- Ligj Nr. 155/2020 "Per ndryshimet Klimaterike"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me qeverisjen:
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjin 107/2016 "Për prefektin e qarkut"
- Ligji nr.139 / 2015 Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 84/2022 'Për buxhetin e vitit 2023', i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"
- Udhëzim Nr. 35 datë 29.12.2022 'Për Procedurat Standarde të Raportimit dhe Monitorimit të Risqeve Fiskale nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe Njësi të Tjera të Sektorit Publik'
- Akt Normativ Nr. 1, datë 21.2.2024 Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, "për buxhetin e vitit 2024"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me planifikimin e territorit:
- Ligj nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar
- Ligji Nr. 9290, Dt 7.10.2004 "Për Produktet e ndërtimit" i ndryshuar me Ligjin nr.9825, datë 1.11.2007 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit"

- VKM nr. 881, datë 14.12.2016, "Për miratimin e planit të përgjithshëm kombëtar të territorit". Fletore Zyrtare nr. 248, datë 23.12.2016.
- VKM Nr. 796, datë 11.12.2019 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar
- VKM Nr. 232 date 17.04.2019 "Pe disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me energjinë dhe burimet natyrore:
- Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)".
- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".
- Ligj nr. 116/2013 datë 15.04.2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)."
- Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- Ligj Nr. 124/2015 "Për Efiçiencën e Energjisë"
- Ligj Nr. 116/2016 Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave
- Ligj Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme"
- V.K.M. nr. 477, datë 16.7.2004 "Për miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos Marinzë".
- VKM nr. 410, datë 13.5.2015, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". Fletore Zyrtare nr. 137, datë 01.09.2015.
- VKM Nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030". Fletore Zyrtare nr. 119, datë 9.08.2018.
- VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare". Fletore Zyrtare Nr. 23, datë 20.02.2018.
- Urdhër i Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr. 148, datë 20.4.1999, "Për Kushtet dhe Normat Teknike, që duhen respektuar në impiantet dhe instalimet e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me mjedisin:
- Ligji, 91/2013, dt 28/02/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"
- Ligji Nr. 57/2020 'Për Pyjet' (i riu)

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore:
- Ligji Nr. 111/2012, Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar.
- Ligji nr.24/2017 "Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit"
- Ligj Nr.8102, datë 28.3.1996 Për Kuadrin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura; i azhurnuar me: Ligjin nr.9352, datë 03.03.2005; Ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 (i ndryshuar me ligjin nr.9845, datë 17.12.2007); Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008
- VKM nr. 147, Datë 18.03.2004, "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave".

- VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me infrastrukturën e transportit:

- Ligji nr.8378, datë 22.7.1998 i Kodit Rrugor Të Republikës Së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.10 488
- VKM nr. 811, datë 16.11.2016, "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe planit të veprimit 2016 – 2020". Fletore zyrtare Nr. 220, datë 25 nëntor 2016.
- Vendimi nr. 53, datë 1.02.2023 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me infrastrukturën e informacionit:

- Ligji Nr. 72/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".
- VKM Nr. 1034, Datë 24-12-2020, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planin e veprimit 2020-2025".
- VKM nr. 553, datë 15.7.2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit".
- VKM nr. 148, datë 24.02.2016 "për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit të Integruar të Informacionit dhe Statistikës së Këshilliit të Ministrave"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me sektorë të tjerë, relevante edhe për çështje të ZRF:

- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social"
- Ligj Nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete"
- Ligji nr.9244 datë 17.06.2004 Për mbrojtjen e tokës bujqësore, i ndryshuar

Aneks 6- Kuadri Strategjik

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Zhvillimit të Territorit, 2015 - 2030 (PPK) – është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit duke parë territorin shqiptar si një të tërë. Duke pasur këtë dokument si referencë hartohen edhe planet sektoriale, planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare, zhvillimit rajonal dhe planet e përgjithshme vendore. PPK ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qendrueshëm

të territorit, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të vendit, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit. duke siguruar njëkohesisht edhe përdorimin racional të tokës. Sa i përket Bashkisë Fier, ai është pjesë e polit të zhvillimit rajonal Vlorë-Fier-Berat, ku Fieri evidentohet si një qendër primare urbane në të cilat mund të përqendrohen funksione me rëndësi primare të kujdesit shëndetësor, arsimore dhe zhvillimit ekonomik e social. Ndër potencialet krysore të këtij poli përmendet fusha e Myzeqesë, porti i Vlorës, Laguna e Nartës, vija bregdetare, kalimi i akseve kryesore rrugore e hekurudhore në vend si dhe kalimi i Trans Adriatik Pipeline (TAP) dhe Ionian Adriatik Pipeline (IAP).

Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar 2016 – është dokumenti i cili shoqëron PKK. Ky dokument është instrumenti kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe ato të zhvillimit të qendrueshëm në procesin e planifikimin strategjik si dhe në vendim-marrje. VSM është dokumenti i cili siguron që konsideratat mjedisore të merren në konsideratë gjatë vendm-marrjes në nivel qendror, rajonal e lokal duke siguruar një zhvillim të qendrueshëm dhe në respekt me mjedisin duke marrë në konsideratë tendencat mjedisore, efektet që politika, plane, projekte të ndryshme mund të kenë në mjedis dhe propozuar masa për të shmangur, zvogëluar, apo zbutur efektet negative në mjedis dhe burimet natyrore.

Dokumenti i Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020 – 2035, (Dokumenti i Politikave Strategjike) – është dokumenti kryesor i planifikimit, i cili rregullon menaxhimin e mbetjeve bashkiake, jo bashkiake dhe të rrezikshme. Dokumenti i Politikave Strategjike merr në konsideratë zhvillimet e planifikimit dhe infrastrukturës në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe përfshirjen e bizneseve private. Dokumenti është zhvilluar mbi vizionin ose perceptimin e konceptit "zero mbetje", në mënyrë që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë e parë dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin dhe parimet e sistemit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e eficencës së perdorimit të produkteve.

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta[ii] - përfaqëson dokumentin e nivelit të dytë të planifikimit në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, i cili përcakton kuadrin e planifikimit në lidhje me investimet infrastrukturore kombëtare,rajonale dhe vendore. Dokumenti për çështje menaxhimi të mbetjeve e ndan vendin në 10 zona mbetjesh, ku Qarku i Fierit konsiderohet si një zonë mbetjesh, dhe parashikon potencialisht zona specifike për secilën bashki në të cilën mund të zhvillohet infrastuktura e menaxhimit të mbetjeve (incerenator, landfill-e, stacione transferimi etj).

Strategjia kombetare e menaxhimit te integruar te burimeve ujore, SKMIBU 2017-2027 miratuar me VKM Nr. 73, datë 7.2.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027" – është dokumenti i cili do të shërbejë si udhëzues për politikat për ujin, dhe të nxisë zhvillime operacionale dhe investime ndërmjet të gjithë sektorëve brenda një afati kohor 10 vjeçar. Kjo strategji zhvillohet në përputhje me legjislacionin vendas dhe atë europian në sektorin e ujit dhe bazohet në 4 shtylla strategjike: 'uji për njerëzit', 'ujë për ushqim', ujë për industrinë' dhe 'ujë për mjedisin'. Me qëllim menaxhimin e ujit, Strategjia e Ujit e ndan vendin në 8 basene ujore kryesore, ku Qarku i Fierit bën pjesë në Basenin Lumor të Semaint. Sa i përket rreziqeve që mund të shkaktohen nga uji objektivi strategjik nr. 3 i Strategjisë së Ujit parashikon disa element kryesorë të cilët janë: a) menaxhimi i katastrofave natyrore në vend, b) sigurimi i mbrojtjes nga përmbytjet; c) përgatitja për përballje me thatësirat dhe kufizimet e ujit; d) plane kontrolli dhe masa për përballjen me ndryshimet klimatike. Këto element duhet të merren në konsideratë në kuadëqr të hartimit të strategjive apo planeve të veprimit në kuadër të ZRF.

Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018 - 2030[iii] - është një dokument paraqet një qasje të integruar për zhvillimin e sektorit të ujit me synim orientimin e investimeve drejt objektivave kombëtarë, përmirësimin e procesit të planifikimit, rritjen e investimeve dhe të ardhurave në sektor, monitorimin e burimeve si dhe mbrojtjen e ekuilibrave mjedisorë. Ky program bëhët i zbatueshëm nëpërmjet planeve të veprimit të cilët përditësohen çdo tre vite dhe përfshijnë masa e aktivitete të cilat propozohen nga aktorët kryesorë në sektor. Ky program i ndan burimet ujore dhe infrastukturën nga pikpamja e përdorimit, impaktit të shkaktuar dhe atij të pësuar në tre shtylla kryesore: a)përdorimi i ujit; b) mbrojtja e ujit; c) mbrojtja nga uji, ku fokus të veçantë marrrin monitorimi i ujërave sipërfaqësore e nëntokësorë, liqeneve, vijës bregdetare të lidhura këto me ndotjen, erozionin, sidurinë e digave etj.

Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri, Maj 2017[iv] është një dokument i hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në vitin 2017 dha ka për qëllim evidentimin e situatës sa i përket sistemit të ujitjes dhe kullimit, digave dhe rezervuarëve për mbrojtjen nga përmbytje. Strategjia synon optimizimin e investimeve në ujitje.kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet me qëllim zgjerimin dhe bërjen të qëndrueshme të sistemeve të ujitjes, përmbushjen e nevojave për kullim dhe mbrojtjen e popullsisë dhe pronave nga përmbytjet.

Strategjia Kombëtare e Strehimit Social, 2016-2025 - qëllimi i strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës të 25,000 familjeve shqipëtare me të ardhura të uleta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të lirë përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm. Strategjia e strehimit social i adreson këto çështje nëpërmjet 6-të programe të strehimit social: Programi i Banesave Sociale me Qira (BSQ); Programi për përmirësimin e kushteve të banesave deri në një ndërtim të ri (PPKB); Programi i banesave me kosto të ulët (BKU); Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; Programi për krijimin e strehave të përkohëshme; Programi për ndërtimin e banesave të specializuara. Në kuadër të ZRF-së, programet më të rëndësishme janë PPKB-ja i cili mundëson ndërhyrje në strukturë për të përmirësuar cilësinë e saj duke e bërë objektin më të qendrueshëm ndaj fatkeqësive dhe programi i strehave të përkohëshme që mundëson strehimin e familjeve që kanë mbetur pa strehë në rast fatkeqësie për një periudhë maksimalisht 2-vjeçare.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit[v] është hartuar për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën, duke synuar përforcimin e koordinimit ndërsektorial në Shqipëri për masat mbi klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky dokument ka një qasje ndër-sektoriale dhe synon të përmbledh pikësynimet dhe objektivat politike të fokusuara të zbutja e efektit të ndryshimeve klimatike të parashikuara në planet dhe strategjitë ekszistuese. Strategjia fokusohet në 4 sektorë kryesorë: a) energjia me fokus kryesor b) transportin, c) bujqësia, d) ndryshimet e përdorimit të tokës dhe pylltarinë të cilët janë edhe baza e raportimeve për inventarin e gazrave serrë në Shqipëri. Me përfshirjen e këtyre sektorëve mbulohet rreth 80% e shkarkimeve të Shqipërisë.
Vizioni kombëtar i strategjisë fokusohet në 3 komponent kryesorë të ndryshimit të klimës: masat zbutëse, adaptimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, ku janë identifikuar edhe 6 përparësi të strategjisë së masave zbutëse:

- SP.1Sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë;
- SP.2Ngritja e një sistemi monitorues, raportues dhe verifikues të GES-it;
- SP.3 Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;
- SP.4 Përmirësimi i ndryshimeve klimatike në planifikimin strategjik sektorial;

- SP.5 Forcimi i kapacitetit dhe ndërgjegjësimi mbi çështjet e ndryshimeveklimatike;
- SP.6 Afrimi me kuadrin ligjor të BE-së për ndryshimin e klimës në të gjithë sektorët.

Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën 2021-2030 (Draft) - bazohet te Strategjia Kombëtare e Energjisë dhe te NDC-të e para dhe është harmonizuar me draftin e NDC-ve të rishikuara. Strategjia adreson pesë dimensioned e Unionit të Energjisë: siguria e energjisë; tregu i brendshëm i energjisë; efiçenca e energjisë; dekarbonizimi; kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria. Për dimensionin e dekarbonizimit synohet minimizimi i shkarkimeve të gazeve të efektit serrë (GES) dhe rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme. Në kontekstin e eficencës energjitike synohet të përmbushen standardet e BE-së (të paktën 32.5% deri në 2030), bazuar në konsumin primar ose final të energjisë, konsolidimi i kuadrit legjislativ për eficencën energjitike, hartimi i strategjisë së rinovimit të stokut të ndërtesave, me objektivin e përgjithshëm rinovimi i 2% të stokut të ndërtesave çdo vit. Për dimensionin e sigurisë energjitike objektivi kryesor është garantimi i një furnizi afatgjatë, të sigurt dhe cilësor për të gjitha sistemet e prodhimit dhe furnizimit të energjisë. Parashikohet nxitja dhe diversifikimi i përshtatshëm i prodhimit të energjisë përmes investimeve të reja, përforcimin e bashkëpunimit dhe integrimit rajonal dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me Acquis e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Përsa i përket dimensionit të kërkimit, inovacionit dhe konkurrueshmërisë, synon që shpenzimet vjetore publike për kërkim shkencor dhe inovacion të arrijnë në total 2% të PBB-së çdo vit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian, SKZHIE, 2022-2030 miratuar me VKM Nr. 88, datë 22.2.2023 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian 2022–2030" është dokumenti kryesor strategjik i cili drejton përparsitë e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit duke i hapur rrugën integrimit të vendit në Bashkimin Europian duke e ndërlidhur atë gjithashtu me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm. Nga ana tjetër ky dokument pararend miratimin e fondeve vjetore të buxhetit të shtetit, duke përcaktuar objektivat e politikave, që përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha institucionet shtetërore. Ky dokument i shërben të gjithë partnerëve ndërkombëtarë të cilët mbështesin vendin në proceset e integrimit në BE.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar PINs Bregdeti 2015 – 2030 është dokumenti kryesor i planifikimit sa i përket Brezit të Bregdetit dhe shërben për të orientuar hartimin e dokumentave të tjerë të planifikimit për zonat bregdetare. Dokumenti vendos theksin e trajtimit të zonës bregdetare si një binom det-tokë me fokus menaxhimin e harmonizuar të nevojës për zhvillim dhe nevojave lokale duke mbrojtur asetet kulturore, historike e natyrore për ta kthet atë në një destinacion turistik. Sa i përket Bashkisë Lushnje në këtë dokument përmendet se kjo bashki rrezikohet nga përmbytjet si pasojë e Lumenjve Seman e Vjosë si dhe nga depërtimi i ujit të detit në tokat bujqësore dhe erozioni detar elementë të cilët duhet të kihën parasyshë për ZRF.

Plani Përfundimtar i Menaxhimit për Basenin Ujor Seman Qershor 2019[vi] - ka për qëllim identifikimin e një sërë masash për përmirësimin e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve ujore të ludhura me Basenin e Lumit Seman duke zhvilluar analizuar gjendjen fizike të burimeve ujore, inventarizimin e burimeve, përdorimin e ujit, identifikimin e sfidave kryesore të lidhura këto edhe në kushtet e ndryshimeve klimatike. Një ndër elementët kryesorë të planit të lidhur edhe me Strategjinë Vendore ZRF është edhe plani i masave të parashikuar në këtë dokument për të parandaluar përmbytjet potenciale, përdorimin e mirë të ujit, monitorimin e vazhdueshëm si dhe

sinjalizimin e hershëm në rast rreziku element të cilët duhet të merren në konsideratë nga institutcionet përgjegjëse të parashikuara edhe në dokument.

Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike, Shtator 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit[vii] (The Fourth National Communication of Albania on Climate Change, September 2022, Ministry of Tourism and Environment) – është një dokument i hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet Klimatike si një detyrim i Marveshjes së Parisit. Ky dokument jep një panoramë të përgjithshme te vendit lidhur me sektorët të cilët emetojnë më shumë gaze serrë në vend e nga ana tjetër jep indicie për impaktin që do të kenë ndryshimet klimatike në vendin tonë në temperaturat mesatare vjetore, intensitetin dhe frekuencën e reshjev, përparimin e detit, presionin ndaj burimeve ujore etj. Ky dokument shërben për të kuptuar situatën aktuale në vend lidhur me ndryshimet klimatike dhe impaktin që ato kanë mbi burimet natyrore dhe gjithashtu jep të dhëna mbi inpaktin që do të ken në vitet e ardhshme duke sugjeruar masa potenciale për të parandaluar apo adaptuar efekteve të ndryshimeve klimatike.

[ii] https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/PLANI-KOMBETAR-SEKTORIAL-PER-MENAXHIMIN-E-MBETJEVE-TE-NGURTA.pdf

[iii] http://ambu.gov.al/public/PROGRAMI%20KOMB%C3%8BTAR%20SEKTORIAL%201%20UJIT%202018-2030.pdf

[iv] https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Strategjia_U_K_korrik__2017_konsultim-1.pdf

[v] https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf

[vi] http://ambu.gov.al/public/Semani%20Final%20RBMP_Final_Alb_June2019.pdf

[vii] https://www.undp.org/albania/publications/fourth-national-communication-albania-climate-change